

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVI i botimit, nr. 186, Prill 2019

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

ME RAMËN E PA RAMËN, ME BASHËN E PA BASHËN, ME ZGJEDHJE E PA ZGJEDHJE, JO MË KANABIS!

nga Prelë Milani

2



Pas këtyre shirave të shumë, papritur vera doli dy javë para Shën Gjergjit, i njohur si shenjtori i stinës më të dashur të njerëzisë. Vera erdhi e mirëpritur e krahëhapur. Ardhësh e bardhë dhe e shkretë pa bimën më të re, e më të shëmtuar të florës shqiptare. Stina e "arit të blertë" kurrë mos lulëzoftë

më! Sahara u bëftë për të toka shqiptare! Mallkuar në jetë të jetëve katili që e pjellë këtë kolerë të përbotshme, e cila dehu e marrosi Shqipërinë e mjerë djathtas e majtas nga koka te këmbët duke e zbuluar kultivatorin më pjellor të Evropës hashashpirëse, e cila monstrubon ditën për diell për vete dhe na bën moral: "- Çfarë bëni ju, ore të marrosur shqiptarë?!"

20 VJET SHOQATA E VËLLAZËRISË KOSOVË - MALËSI E MADHE "MARTIN DRESHAJ"

Me 12 prill 2019 në Pejë, Shoqata e Vëllazërisë Kosovë - Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë, dhe Komuna e Pejës, organizuan Manifestimin tradicional kulturor "ZËRI I VËLLAZËRISË - 2019", që ishte takimi në përkujtim të rënies heroike me 12 prill 1999, të dëshmorit Shaqir Ramë Tahiraj.

Takimi nisi në fshatin Fierzë (ish Novoselë) ku u bënë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve dhe u vunë kurora lulësh, në nderim të rënies heroike të Shaqir Ramë Tahiraj, të gjithë luftëtarëve dhe martirëve të kombit.

Pastaj në Teatrin "Istref Begolli" në Pejë, organizohet mbledhje kulturore e artistike, folklorike. Manifestimi nisi me himnin kombëtar dhe një minutë heshtje për dëshmorët e rënë në të gjitha shqiptare.



8

GAZETARI FOTO PROKO, KUJTIME PER ZEF MALËN

5

Të tregosh apo të shkruash për Zefin është kënaqësi dhe përgjegjësi njëkohësisht, sepse Ai jo vetëm që ishte intelektual i kompletuar, por i vlerësuar me notën më të lartë; shkëlqyeshëm. Në ditët e para të dekadës së tretë të muajit nëntor të vitit 1961, unë sillsha si i ndërkryer në rrugët dhe kafenetë e Tiranës. Prisja arrestimin tim. Dhe ai nuk vonoi. Kisha ngrënë drekën së bashku me Fadil Kokomanin në restorant "Vollga", mandej hyra në aneksin e tij për të pirë kafe. Sa e vura në gojë, u duk "kaleci" im. Kishte një vit që më ndiqte si një qen kudo që shkoja.

PARAQITJA E LIBRIT "DUKAGJINI YNË - IV", KLERIKË TË SHQUAR

Të dielën e 31 Marsit në sallën "Kardinal Mikel Koliqi", në një atmosferë të ngrohtë pranverore u promovua libri "Dukagjini ynë - IV, klerikë të shquar" të autorëve Prelë Milani dhe Lazer Kodra, të dy ambasador të ruajtjes dhe përcjelljes me mjeshtri të vlerave dukagjinase.

Kjo veprimtari erdhi e organizuar me mjaft mjeshtri nga Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me Komisionin "Drejtësi dhe Paqe".

Ky libër vjen në vijimin e promovimit të librave të Dukagjinit dhe 3 vëllimeve tjera ...

3

T'I MBROJMË SPECIET TONA - DITA E TOKËS 2019

13

Dhurata e natyrës në planetin tonë janë miliona specie që njohim dhe i duam, dhe shumë më tepër që mbeten për t'u zbuluar. Për fat të keq, qeniet njerëzore kanë çrregulluar në mënyrë të pakthyesme bilancin e natyrës. Bota po përballet me shkallën më të madhe të zhdukjes së shpejtë të specieve; kjo është rezultat i aktivitetit njerëzor. Reduktimi i shpejtë i popullsisë së bimëve dhe kafshëve të egra janë të lidhura drejtpërdrejt me shkaqet e nxitura nga aktiviteti njerëzor: ndryshimi i klimës, shpyllëzimi, humbja e habitateve, trafikimi dhe gjuetia, bujqësia ...

SI NDIKON GËZIMI, LUMTURIA E QESHURA DHE USHQYERJA MBI SHËNDETIN?!

Sipas një studimi Australian në 10 mijë veta tregohet, se ato që janë shumë të lumtur, të gëzuar, të kënaqur janë mirë me shëndet deri në 3-vjet më vonë.

E qeshura është një paravendosje ose kundër-vënie për sëmundjet e zemrës, nën efektin e saj krahas ndikimit të gjik pozitiv, qeshja shërben si gjimnastikë...

11

ME RAMËN E PA RAMËN, ME BASHËN E PA BASHËN, ME ZGJEDHJE E PA ZGJEDHJE, JO MË KANABIS!



nga Prelë Milani

Pas këtyre shirave të shumë, papritur vera doli dy javë para Shën Gjergjit, i njohur si shenjtori i stinës më të dashur të njerëzisë. Vera erdhi e mirëpritur e krahëhapur. Ardhësh e bardhë dhe e shkretë pa bimën më të re, e më të shëmtuar të florës shqiptare. Stina e "arit të blertë" kurrë mos lulëzoftë më! Sahara u bëftë për të toka shqiptare! Mallkuar në jetë të jetëve katili që e pjellë këtë kolerë të përbotshme, e cila dehu e marrosi Shqipërinë e mjerë djathtas e majtas nga koka të këmbët duke e zbuluar kultivatorin më pjellor të Evropës hashashpirëse, e cila monstrubon ditën për diell për vete dhe na bën moral: "Çfarë bëni ju, ore të marrosur shqiptarë?!"

Duke mos pasur durim të dëgjoj retoriket hipokrite politike për virgjëri kur secila palë është ngjeshur publikisht me hashashin. Duke mos pasur durim të bëj klasifikimin e rajonizimit gjeografik, pasi nuk ka fshat e as krahinë që nuk është mpleksur përpara hashashit të harbuar shqiptar

Dua të ndalëm atje ku më dhemb më shumë te DUKAGJINI IM – NDERI I KOMBIT!

Atje në çatinë më verore të bjeshkëve tona gjendet gjymtyra me karakteristike e kombit artikular udobisht nga studiuesit si trajta shoqërore partikulare. Atje ku siç thoshte Koliqi ynë: - "Nuk shkeli këmbë tjetër veç asaj të mbathur me çorape dhe opinga malësorit".

Ato podina të qëndisura me gjelbërim pyjesh e livadhesh të mëndafshita, rrethuar me kordonë ka mbi 20 vjet që janë mbuluar nga një re e zezë vampirë, që ka ulur në gjuhë krenarinë dhe betimin historik: "- Unë

jam shqiptar dhe Zot në vendin tim! Jetoj si çetina e ngulur në shkëmb, në zgrip jo për një grusht, por për dy gisht fytyrë".

Asnjë specie invaduese nuk i ka sjell rrënim më të madh ekonomik Dukagjinit se "Luci Ferri" i veshur me petkun e kamufluar të "Luci Dritës".

Asnjë sistem politik që "lulëzoi" apo pllakosi këtë krahinë tash 107 vjet, nuk solli një rrenim moral më të shëmtuar se "Shën Hashashi" i huazuar pas pos pilafit nga Donkishotë humbës të këtij bixhozi të fëlliqur.

Kryqet e varreve që bëjnë hije mbi kryet e tatave dhe lokeve tona sokolesha, askush nuk i shëmtoi me blasfemi të tillë si paganët e ndërkyer që pushtuan malet më bimën e djallit.

Bjeshkët rrezëllitëse kurorë - kurorë të Dukagjinit, ngjasojnë si bide e pa ujë e mbushur nga jashtë qitjet e neveritshme të çakenjëve të opiumit.



Deri kur Dukagjini gojëmyllur do durojë izolimin urbanistik, ku në vend të petkut të xhevahirtë të turizmit vijon të mbajë kapotën e shkurtër të zhveshur të kanabisit?

Deri kur inteligjenca, rinia shkollare, diaspora e integruar, punëtorë të ballëdjersitur, mjeshtrit duarartë, çikat si rreze, nënat dhe baballarët devotshëm do të durojnë t'u turbullojnë ujin e kristaltë të gurrave tona disa "të palarë" që nuk përfaqësojnë gjë tjetër veç bajgat e kësaj zone?

Deri kur administrata e Njësisë Administrative të kësaj treve gjeografikisht shpatullgjerë e shpopulluar përdhunshëm do vijë në rrinë në "azil" në Shkodër si e ashtuquajtura qeveria

Esat Pashës në Paris pa marrë parasysh detyrën e vet legjitime të administrimit të territorit?

Edhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", që ka bërë punë aq të vlerata kulturore duhet të jetë shumë aktive, me propagandën sensibilizuese për çlirimin e Dukagjinit nga hashashi.

Vetëm gjatë vitit 2018, në grupet e plan kontrollit të territorit kanë operuar mbi 1500 forca policore, fort më shumë se ushtria e Shefqet Turgut Pashës me 1910. E përse gjithë kjo asqeri, për çlirimin e Dukagjinit prej dreqit që dimëron në fushë e del për verim në male tona të shkreta?!

Ju të nderuar ish krerë parik të Dukagjinit, që tervesën e madhe nuk ia lëshoni askujt, ku jeni tash 20-vjet?

A shihni si ua kanë dhunuar në mënyrën më banale logun e fisit, drumin e krerëve, besën e motmotit, të gjasë e çobanit?

- romantike timen, por dramë është degradimi dhe bjerrja e marrëveshjes dhe besëlidhjes qoftë edhe për problemet madhore shoqërore të një bashkësisë.

Po ju të nderuar klerik, për kë i keni mallkimet kur nuk syzoni lugetërit e hashashit e të kokainës?!

Deri kur do u puthni dorën politikanëve duke u rezervuar vendet e para në Kishë?!

Deri kur në pritjet ceremoniale më buzëqeshje mëshiruese do të cakëroni gotat e shampanjës, mëkatarëve më mëdhenj të këtyre 30 viteve?!

Ata të cilët po të duan me një pakt brenda 5 minutash e thajnë me gjethe e me rrënjë kanabisin e Shqipërisë.

Më trishtim konstatoj, se parandalimi dhe lufta kundër kanabisit i delegohet dhe pritët si mrekuilli e policisë. Pjesa e madhe e policisë ka bërë e vijon të bëjë luftë trimërie dhe sakri-

fica të larta në këtë luftë të gjatë në çdo sitë. Fatkeqësisht ka pas raste që edhe punonjësit e drejtues policie i kanë zhytur duart në këtë hale, por ata nuk përfaqësojnë policinë e shtetit, por askaridet e korrupsionit që ka ngjyrën e zezë që emrin dhe mbiemrin e atij që shkon në shtratin e tij dhe çdo polic të botës ka të tillë.

Vitet 2017-të e 2018-të kanë qenë vitet e një lufte të fituar ndaj kanabisit në Dukagjin - Shkodër dhe në shkallë vendi. Ata që mendojnë, se polica mund të humbë fitoret e arritura gabohet rendë.

Më Ramën e pa Ramën, me Bashën e pa Bashën, me

zgjedhje e pa zgjedhje kanabisi do vijojë të luftohet pa kompromis.

Ju, që e mbani gjarprin kulaç në gji u këshilloj, hiqeni fluturim pasi sa të nxehet koha do ju kafshojnë të parët ju që iu bëtë strehë.

Ju, që farën e keqe e keni hedhur në kubikë dhe e mbani të fshehur birave, do t'ua hajë dreqi para se ta mbjellin në ugar.

Ju, që mendoni se do rrisni dreqin në djep mos u lodhni, mos u shpenzoni, se nuk do ta korrni! Edhe po u korr ndopak, nuk do e shini as nuk do e çoni në mulli pa shkuar atje ku do hani bukë falë.

Ani, se në quajtshi lajthitje arkaike

PARAQITJA E LIBRIT “DUKAGJINI YNË - IV”, KLERIKË TË SHQUAR

Të dielën e 31 Marsit në sallën “Kardinal Mikel Koliqi”, në një atmosferë të ngrohtë pranverore u promovua libri “Dukagjini ynë - IV, klerikë të shquar” të autorëve Prelë Milani dhe Lazer Kodra, të dy ambasador të ruajtjes dhe përcjelljes me mjeshtëri të vlerave dukagjinase.

Kjo veprimtari erdhi e organizuar me mjaft mjeshtëri nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me Komisionin “Drejtësi dhe Paqe”.

Ky libër vjen në vijimin e promovimit të vlerave të Dukagjinit dhe 3 vëllimeve tjera në të cilat paraqesin: Vëllimi i parë, një paraqitje e përgjithshme e vlerave historike të Dukagjinit; vëllimi i dytë një paraqitje e artistëve të shquar, vëllimi i tretë, paraqitja e sportistëve të shquar, vëllimi i katërt na paraqet klerikët e shquar të Dukagjinit.

28 klerikët e shquar të përshkruar me veçori specifike stili nga pema gjenealogjike e Dukagjinit, ku 8 prej tyre janë martirë të flijuar për qëndresën në besim që bënë, 8 mendje të ndritura të kulturës Shqiptare, 6 perla të sferave të larta të klerit dhe të tjerët një vlerë e çmuar e qëndresës së vlerave dhe besimit, që kombi ynë dhe Dukagjini përfaqëson.

Rëndësinë e kësaj veprimtarie do ta rriste sigurisht pjesëmarrja e personaliteteve të shquar nga të gjitha fushat e jetës së vendit tonë.

I ftuar i veçantë ishte Arqipeshkvi i Dioqezës Shkodër – Pult, Imzot Angelo Massafra, i cili mbajti edhe fjalën e tij përshëndetëse duke përgëzuar autorët, por edhe duke u bërë thirrje të gjithë të pranishmeve për ruajtjen e vlerave tona, për përcjelljen e tyre brez pas brezi, por edhe për të nxitur paraqitjen e informacioneve për të tjerë klerikë, që duhet të jenë dëshmi të ruajtjes në kujtesën e secilit prej nesh.

Një kritikë dhe vlerësim mjaft pozitiv erdhi edhe nga kryeredaktorja e gazetës Dukagjini znj. Suela Ndoja, që paraqiti me detaje çdo veçori stili në të shkruar dhe në përmbajtje për këtë vepër.

E pranishme në këtë veprimtari ishte kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, znj. Greta Bardeli, e cila përveç fjalës përshëndetëse, duke përgëzuar për librin dhe duke dhënë një mesazh sidomos për të rinjtë, të cilët duhet të jenë krenare për prejardhjen Dukagjinase, ku theksoi se është edhe ajo një prej tyre, ajo kishte ardhur edhe me një mision të veçantë të nderonte konsullin e nderit të Austrisë z. Gjergj Leqejza “Nderi i Qarkut Shkodër” me motivacionin “Në shenjë nderimi për kontributet në fushën

e shoqërisë civile. Mbështetës të veprimtarive me impakt në zhvillimin social e kulturor të qarkut Shkodër”, si dhe kryetarin e Komisionit “Drejtësi dhe Paqe”, z. Luigj Mila “Nderi i qarkut Shkodër”

me motivacion “Në shenjë nderimi për kontributet në fushën e shoqërisë civile. Mbështetës të veprimtarive me impakt në zhvillimin social e kulturor të qarkut Shkodër”.

Në fjalën e tyre përshëndetëse u shprehën, se ishin të emocionuar nga titulli dhe me përgjegjësi sigurisht për të vijuar në përcjelljen edhe më shumë vlerave që ata përfaqësojnë secili në sektorin e tij.

Opinion për librin mbajti dhe kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj, që theksoi meritën e autorëve në këtë kërkim dhe hulumtim dhe në veçanti dha opinionin për At Jak Marlekën apo profesor Luigj Marlekaj. Gjithashtu u zotua, se gjithmonë do të jetë mbështetës për studimin dhe paraqitjen e figurave e personaliteteve të tjera të dalë nga kjo zonë me histori e kontribute kombëtare, të cilat vijojnë që në lashtësi.

Opinion për librin mbajti dhe studiuesi z. Aleks Dushi, i cili u ndal tek pjesët që i kishin lënë mbresa duke rritur interesin për lexim nga të pranishmit.

Opinion për librin mbajti dhe studiuesi z. Luigj Shyti, që në veçanti u shpreh, se kjo seri librash

të shkruar nga autorët përbëjnë një vlerë të patjetërsueshme në librarinë dhe vlerat tona si komb.

Opinion për librin mbajti gjithashtu dhe z. Kadri Fikaj, znj. Mimoza Rexhvelaj, aktori Frederik Fistani, të cilët në mënyrë të veçantë u ndalën te stili i paraqitjes dhe në përdorimin e një fjalori të pasur, të kuptueshëm dhe tërheqës për lexuesin. Z. Frederik i dorëzoi dhe tre relika të kishës së Thethit, Imzot Massafres.

Në emër të shoqatës së persekutuarve, dega Shkodër, përshëndeti dhe Z.Filip Guraziu, i cili u ndal te rëndësia e këtij libri, që te brezi i ri dhe ata që do vijnë të njihen me krimet e komunizmit dhe të mos lejojnë të vijnë diktaturat në pushtet.

E gjithë veprimtaria u prezantua me mjeshtëri, emocion dhe me recitimin e disa vargjeve të Fishtës nga z. Pulin Ujka.

Gjithashtu recituan pjesë nga vargjet e veprës znj. Vitore Kodra, znj. Donatela Kodra, znj. Klodjana Serraj si dhe fëmijë nga shkolla 9-vjeçare, me te cilat u beprania e të gjithë brezave.

Kjo veprimtari u vlerësua dhe nga pjesëmarrja e Profesor Romeo Gurakuqi, Profesor Ahmet Osja, N/kryetari i Qarkut Shkodër, z. Maxhid Cungu, kryetari i Shoqatës Atdhetare “Malësia”, z. Ilmi Kurti, i cili dhe përshëndeti në emër të shoqatës që drejton.

Përshëndeti dhe Z.Ndue Ftoni, ai, që ka lindur së bashku me bujarinë, i cili në mes të tjerave tha: “Njeriu bujar, mban kuletën në dorën e majtë pranë zemrës, se po nuk pate zemër nuk mund të japësh Opinion për librin. Mua mu dha mundësia dhe kam dhënë e besoj se edhe do të jap përsëri e përsëri, sepse këta, si Prela e Lazeri duhen mbështetur, se nuk punojnë për vete, por punojnë për vlerat e dukagjinaseve kudo ndodhen.

Sa mirë që Shqipëria dhe Dukagjini ynë ka njerëz z. Ndue Ftoni dhe të tjerë që investojnë dhe mundësojnë në rritjen e vlerave dhe paraqitjen e tyre në vepra për t’i ruajtur në dëshminë e kujtesës së secilit, “Paçin e Dhënçin gjithmonë!”

Urime Prele Milani e Lazer Kodra dhe u zhvillofshin përsëri e përsëri ceremoni të tilla, për punën tuaj hulumtuese, studiuese e krijuese!

Në fund të ceremonisë, për pjesëmarrësit zoti Gjergj Leqejza e Luigj Mila, dhanë një koktej të plotë!

Përgatitur nga Klodjana Serraj



OPINION RRETH LIBRIT "DUKAGJINI YNË IV: KLERIKË TË SHQUAR".



(Nga fjala e mbajtur
në Promovimin e Librit)

Po filloj me një pyetje të thjeshtë: cili është objekti dhe motivimi i të qënurit të mbledhur së bashku këtu sot?

Objekti lidhet pikërisht me ftesën që na kanë bërë zotërinjtë e nderuar Prelë Milani dhe Lazer Kodra të cilët bëjnë pjesë në radhën e personaliteteve të rëndësishme të kulturës dukagjinase përmes veprave që kemi marrë deri tani prej tyre duke u treguar njohës të mirë të psikikës njerëzore, njohës të mirë të traditave dhe zakoneve dukagjinase duke e shpalosur me mjeshtëri nëpërmjet trashëgimisë së tyre krijuese. Dhe ja, pikërisht sot jemi fokusuar tek libri i tyre i fundit "Dukagjini ynë IV: Klerikë të shquar".

Pse është e domosdoshme dhe interesante të diskutohet rreth klerikëve të Dukagjinit?

Ndërsa lexoja librin, më erdhi në mendje një thënie e poetit dhe novelistit, Cesare Pavese "Të shkruash është bukur sepse bashkon dy gëzime: të flasësh me veten dhe të flasësh me të tjerët". Lidhur me këtë, kur flitet e shkruhet për Dukagjinin, çdo pjesë e jotja bëhet dukagjinase sepse çdo mendim e veprim sillet rreth tij e këtu nuk mund të bënte një përjashtim as edhe një diskutim që zhvillohet rreth klerikëve dhe martirëve të cilët siç e thekson edhe vetë historiani Prelë Milani "janë nga loza e Dukagjinit". Dikush me të drejtë mund të thotë se janë bërë shumë artikuj në lidhje me figurat e shquara në Dukagjin dhe për këtë arsye besoj se është momenti për të cilësuar natyrën e veçantë të përshkrimit të figurave të shquara fetare që kontribuan dhe dhanë jetën e tyre për atdheun. Gjithashtu thekson një nevojë historike për tu adresuar vëmendjen e duhur këtyre klerikëve me identitet dukagjinase. Po, ata ishin dukagjinase. Ndoshta nuk e zgjodhën të ishin dukagjinase por vetë Zoti dhe fati deshën të ishin nga Dukagjini. Pra Dukagjini është pjesë integrale e përbërjes së tyre fizike, gjenetike e shpirtërore.

Në këtë libër autorët e nderuar paraqesin panoramën e klerikëve dhe martirëve dukagjinase në rrjedhat e saj të zhvillimit historik si një nga manifestimet më të fuqishme të shpirtit dukagjinase, duke ruajtur atë koherencë të brendshme, që shquhen në përzgjedhjet e tyre nga fillimi deri në fund për të demonstruar qëndrim mbrojtës dhe heroik si katolikë të denjë shqiptar.

Puna pasionante e autorëve në fushën e historisë dukagjinase kushtuar klerikëve dhe martirëve dukagjinase jepet përmes përmbajtjes dhe kontributeve konkrete që

ata sjellin me këtë vepër. Në kulturën dhe inteligjencën profesionale që i karakterizon autorët në fjalë, ata vihen robërisht në shërbim të punës për të ingranuar sipas mundësive kulturën dukagjinase me nivelet e kohës nëpërmjet krijimeve origjinale artistike të poetit Lazer Kodra.

Nëpërmjet këtij vëllimi, kemi mundësinë të njihemi një koncept inovativ e të plotësuar, refleks të një vetëdije të qartë, me një përkushtim të tillë që shpërfaqet fuqishëm në disa fusha krijimi, si në atë të krijimeve të mirëfillta letrare, dhe atë të pasqyrimin historik. Ky i fundit bazohet në të dhëna parësore dhe dytësore me referenca të forta bibliografike.

Për të vijuar me *përmbajtjen*, në librin "Dukagjini ynë IV Klerikë të shquar" vihet në dukje një ndarje paralele. Në ndarjen e parë karakterizohen *fatosat e lumnueshëm* si At Bernardin Palaj, At Gjon Shllaku, Dom Lazer Shantoja, Atë Çiprian Nika, Dom Mark Xhani, Dom Dedë Plani, At Gaspër Suma e Gjëlosh Lulashi. Në këtë ndarje, autorët trajtojnë tema që kanë rrënjë në karakterin e fortë dhe inteligjencën e lartë të Klerikëve dhe martirëve të Dukagjinit dhe që tragjicitetin e vet e provojnë si në mesin autentik ashtu dhe në ndeshjen e tyre me mjedisin kohor. Këtu zë fill jeta në përjetësinë e saj dhe në zjarminë e saj të ndërtimeve. Toni i përgjithshëm është autentik-tragjik duke marrë parasysh se cili ishte përfundimi i tyre.

Lidhur me këtë, me të drejtë mund ti referohemi edhe kompozitorit francez, Hector Berlioz "Koha është një mësues i madh por për fat të keq vret të gjithë nxënësit e vet". Kjo, pasi qëndrimi i tyre i jashtëzakonshëm ndaj kohës pushtuese solli asgjësimin e tyre klerik.

Psh, Atë Bernardin Palaj i cili ishte një njohës i shkëlqyer i maleve tona të Dukagjinit, mitolog, figurë elitare e klerit francezkan, poet, folklorist, studiues i letërsisë dhe historisë është pozicionuar legalisht në krahun e atyre lëvizjeve dhe grupimeve politike që mendonte se e përfaqësonin aspiratën më të mirë për progresin dhe modernizimin e Shqipërisë që e donte po aq sa kishën, së cilës i shërbente gjithë devocion. Lidhur me këtë figurë historike shqiptare, kanë shkruar personalitete të shquara ndër ta edhe At Zef Pëllumbi që e quan *zogu I rrallë*. Dhe gjithashtu poeti Lazer Kodra i kushton poezinë *Ti nga qeli shëndrite*.

At Gjon Shllaku, shëlbues i ndërjegjes kombëtare, si tek të gjithë etërit e tjerë edhe tek Atë Gjoni mbizotëronte binomi "Fe dhe Atdhe" dhe iu kushtua gjithnjë mbrojtjes së drejtave të njeriut pavarësisht se ndaj tij u vërsulën shumë akuza ai mbeti hero i katolicizmit i cili përfundoi i pushkatuar si mëkatar i kohës së komunizmit.

Dom Lazer Shantoja, një poet i lindur, prozator i spikatur, gojëtar i pashoq, deputet dhe veprimtar politik. Në shkrimet dhe kumtesat e tij përcillte mesazhin e optimizmit, të besimit në forcën dhe qëndrueshmërinë e popullit të vet. Rruga për të ecur përpara, është kur secili bën pjesën e vet. Ai i hapi luftë të hapur komunizmit dhe ka qënë i linjës ultraradikale bazuar në një ideologji botërore për të cilën ishte gati të luftonte

si gladiator. Mbetet një figurë komplekse, u flijua dhe mbeti pa varr

Atë Çiprian Nika, guardian i fretërve, mbetet në Martirët e Krishtërimin, model i masakrës së sigurimit komunist antiatdhetar i cili edhe vdiq si beniamin kulture e qytetërimi.

Dom Mark Xhani, kleriku që e hëngrën qentë e Shpalit, në Mirditë ndër më tragjikët e klerit katolik shqiptar

Dom Dedë Plani, nxënësi i Jezuitëve, me një jetë të thjeshtë, nuk la pas kryevepra në fusha të dijes por dëshmoi se ishte edhe njeriu i butë e më delikat, si bëhet trim si zana kur është fjala për të mbrojtur një ideal, që vlen më shumë se jeta, madje i kapërcen kufinj të jetës. I rezistoi torturave si Prometeu dhe nuk nxorri asgjë

At Gaspër Suma, Martir i Kishës së Shenjtë. Autori Lazer Kodra i dedikohet me poezinë *Rreze Ylberi ndër vite*: por dhuna ka vetëm një fytyrë, O Atë, të vrasë, të presë e të sundojë, ndaj të mbyten në burg o i pafat, vetëm që ajo të rojë.

Gjëlosh Lulashi, antikomunist martir i kishës katolike

Përmbledhtazi, të gjithë këta klerikë e martirë që përshkruhen në këtë ndarje, të udhëhequr nga inteligjenca e tyre pavarësisht se të varfër, ata arritën të shkëlqenin në formimin e tyre perëndimor. Autorët e nderuar vënë në dukje se pavarësisht rrugëve dhe strategjive të veprimit që përdorën, klerikët aspironin për një Shqipëri etnike, konstitucionale, të pavarur, me drejtësi të mbështetur ekonomikisht të zhvilluar, me demokraci të standarteve perëndimore, në epiqendër të të cilave të ishte gjithmonë e jetës ideja kombëtare.

Kurse në *ndarjen e dytë* të titulluar *Mendjendritur dhe qëndresëtarë të paepur*, autorët kategorizojnë Dom Ndoc Nikaj, Kardinal Mikel Koliqi, Atë Pjetër Meshkalla, Atë Gegë Lumaj, Dom Nikollë Gjini, At Ferdinand Pali, At Frano Kiri, matematikeni e njohësi I gramatikave të huaja, Dom Mark Shllaku, Prof Luigj Marlekaj, Imzot Frano Gjuraj, Imzot Pjetër Gjura, Atë Bernardin Shllaku, Padër Ludovik Kiri, Padër Anton Kiri, Dom Mark Shllaku, Mons, Nikoll Shllaku, Atë Daniel Gjeçaj, Dom Prekë Ndrevasaj, At Ambroz Martini dhe Dom Lazer Sheldia.

Nëpërmjet këtyre mendjendriturve trajtohet më shumë jeta, shpalohet mentaliteti i vendit, një harmoni e jetës autentike e cila merr shqetësime dhe me ambicet e ndryshme, që zbulojnë karakteret, zbulojnë kamjet e skamjet e kohës në të cilën ishte zhytur vendi ynë.

Klerikët dhe martirët dukshëm mbrojtën traditën shqiptare kundrejt elementeve të huaja dhe dëshira e tyre ishte të rindërtohen vlerat, të përdoren, ndërsa për t'u eliminuar duhej veç dukuritë negative.

Ky botim njih një shumësi vlerash që i solli historisë dhe kulturës së Dukagjinit, çështjet që na përçohen neve si brez dhe të gjithëve. Teksti bashkë me një qëndrim autorial merr një ton të hollë therrës, që nuk ngjitet në nivel të tragjikes. Trajtimi i çështjeve të tilla i bëjnë autorët njohës e interpretues strukturalistë dhe funksional-

istë njëkohësisht të vlerave entografike dhe antropologjike të kontribuesve shqiptar me prejardhje dukagjinase.

Nëpërmjet këtyre figurave fetare e atdhetare, autorët i mëshojnë fort argumentit të tyre të preferuar se populli shqiptar që lëshoi rrënjë para mijëra vjetësh në një truall ku u ndeshën dhe u përplasën kultura të ndryshme, ruajti përballë tallazeve tiparet themelore individuale si komb pikërisht në sajë të karakterit të fortë. Trajtohen virtutet që i kanë karakterizuar fatosët dhe mendjet e ndritura, ato gjëra që i kanë mbajtur të fortë përballë çdo stuhie të jetës, të ndershëm e të pathyeshëm.

Në këtë vëllim është derdhur mjeshtëria e shkrimit të autorëve, ashtu si janë shprehur pikëpamjet themelore mbi botën shqiptare duke përshkruar personalitetin e personazheve kryesore të vëllimit.

Në këtë vepër shfaqen idetë për transformimin e jetës në të cilën bënin pjesë klerikët dhe martirët, ashtu si dhe pengesat e pakalueshme për këtë transformim. Te historitë personale të klerikëve dukagjinase paraqitet një përshkrim me realitetin e vet të ashpër, duke zbuluar botën e fshehur të dëshirave të njerëzve, shpirtin e celur po edhe shpirtin e mykur që përkundet në errësime të kohës uzurpuese.

Së fundmi, nga vëllimi i dy autorëve ne marrim dije e ide të reja, mirëpo në thellësitë e tij shpirtërore rri një kulturë jetësore e ambientit e cila fle, por zgjohet nëse preket në themelet e saj. Ky vëllim shtron çështjen e ndeshjes të projektit të ndricimit kulturor me realitetet e thella shpirtërore: *të besosh në diçka dhe të jesh gati të japësh jetën për të*. Këto ndeshen dhe fiton shtresimi i moçëm, që do të thotë se ai s'është vetëm obligim kanunor, po një qenësi me strukturë psikologjike.

Si *rrekomandime* të mundshme mund të ndërthurim:

Së pari: Nuk mund të tregohemi analfabetë emotive ndaj fatosëve të lumnueshëm dhe mendjendriturve të paepur që në përkthim të thjeshtë do të nënkuptonte mungesën e ajrit psikologjik, prandaj ju ftoj që ta lexoni këtë libër dhe të reflektoni rreth.

Së dyti: klerikët kanë ndihmuar një komb shqiptar por veprat e tyre janë akoma të pabotuara siç janë të Atë Daniel Gjeçaj, është akoma i pabotuar plotësisht Meshari I Lutjeve. Respektivisht do të ishin të sugjerueshme botime monografike të veçanta

Së treti: Siç është thënë nga At Ambroz Martini, Dukagjini është zemra e ilirëve, zemra e Shqipërisë, buka më e pastër e sofrave ilire ne fare mirë mund ta interpretonim me një ftesë për çdo dashamirës të vlerave të Dukagjinit, të vijoje me një botim *Dukagjini ynë V* me figura të tjera të shquara që mund të mos jenë përfshirë në këtë vëllim.

Duke përgëzuar autorët e nderuar Prelë Milani dhe Lazer Kodra, ju faleminderit për vëmendjen tuaj.

**Përgatitur
nga Suela Ndoja**

GAZETARI FOTO PROKO, KUJTIME PER ZEF MALEN

NË 104 VJETORIN E LINDJES E SJELLIM NË KUJTESE ZEF MALEN

Me Zef Malën, në internim dhe në burg, nga gazetari FOTO PROKO -

Kujtime:

- Të tregosh apo të shkruash për Zefin është kënaqësi dhe përgjegjësi njëkohësisht, sepse Ai jo vetëm që ishte intelektual i kompletuar, por i vlerësuar me notën më të lartë; shkëlqyeshëm. Në ditët e para të dekadës së tretë të muajit nëntor të vitit 1961, unë sillsha si i ndërkrayer në rrugët dhe kafenet e Tiranës. Prisja arrestimin tim. Dhe ai nuk vonoi. Kisha ngrënë drekën së bashku me Fadil Kokomanin në restorant "Vollga", mandej hyra në aneksin e tij për të pirë kafe. Sa e vura në gojë, u duk "kaleci" im. Kishte një vit që më ndiqte si një qen kudo që shkoja. Më urdhëroi t'a ndjek nga pas për në Degën e Punëve të Brendshme, e cila gjendej "tek Selvia" e famshme, që ishte bërë tmerr për sa e sa "fatlumë" kryeqytetas. Hymë në oborrin e ngushtë. Survejesi më dha urdhër të prerë: "Mos luaj nga vendi" dhe mori përpjetë për nga shkallët. Ndërkohë rreth dhjetë hapa larg meje ve re një meso burrë, me një shkop në dorë, me syza dhe me një kasketë me strehë dhe pardesynë në një ngjyrë që nuk munda t'a përcaktoja aty për aty, me një deng të qepur, brenda të cilit mesa dukej kishte shtresa dhe mbulesa. Por gjithsesi i paprangosur.

- Ecte me hapa të matur, mendueshëm. Sa dëgjoi zërin e shoqëruesit, ndali hapin, ngriti kryet dhe hodhi vështrimin në drejtimin tim. Ndërkohë u fanit tek shkallët e katiit të dytë Qemal Balluku dhe që aty nuk m'u drejtua mua direkt, por atij shoqëruesit:

- "I thuaj atij, se me vendim të Komisionit Qëndror të Dëbim Internimeve është i dënuar me pesë vjet internim në ishullin e Zvërnecit".

- Shoqëruesi doli jashtë oborrit për t'u rikthyer pas pak me një gaz "Molotov" dhe në këtë interval kohe më afrohet burri me bastum:

- Jam Zef Mala, mos u baj marak do të jena bashkë. Kam dëgju, se është një vend i bukur, me pisha e ullinj do të ketë dhe të tjerë, do ja kalojmë për mrekulli. Por më vjen keq, se je djalë i ri. Veç po të thom (duke m'u afruar tek veshi) se këta se kanë të gjatë, punë mujsh e na përsëri do jena të lir...."

- Edhe pse kanë kaluar qysh atëhere 40 e kusur vjet ato fjalë të ëmbla të atij burri kurajoz, po më tingëllojnë edhe tani që po hedh këto rjeshta në letër.

- Afër mbrëmjes na hipën në atë "gaz" me oficerin e "degës" përpara, me gjashtë policë, me automatikë, krahë-qafë, me gishtat tek këmbëzat e tyre. "S'ka dys-

him se po shoqëronin dy kriminelë të rrezikshëm", u nisëm drejt Vlorës për në ishullin e Zvërnecit. Mbërritëm pas mesit të natës, gjindja ishte në gjumë: shoqëruesi na futi në njërën prej dhomave të Manastirit, na kyçi nga jashtë dhe u largua për në komandë. Natyrisht që ishte një natë e trazuar, nuk vumë gjumë në sy, Zefi ndër të tjera më tha dhe këto fjalë:

- "Je djalë i ri në moshë, unë tashmë kam kalu shumë vështirësi, kam qenë i burgosur në Brazhdan, në Itali, në Ventotene, në burgun e Burrelit, në atë skëterrë. Njerëzit jashtë mureve të tij ishin të lirë, ndërsa na kacafytësim me mortin. Kam ndigju klithma, kam pa njerëz të lidhur duarsh e kambësh, t'u u godit egërsisht prej njerëzish të egër, të pashpirt;

- Hiqesha vetë zvarrë t'u qenë me dizanteri për me shku në banjë e zvarrë për me u kthi në qeli, por njeriu asht i fortë si shkami. Kena me pa si do na trajtojnë këtu".

- "Si të bahet or Zef", i them.

- Të nesërmen në mëngjes gjindja ishte poshtë në katuan e asaj dhome, që u gëdhimë atë natë të trazuar. Shifnin nga të çarat e dyshemesë dhe na pyesnin me rradhë, se kush ishim ne. U zgjatëm fytyrat në ato të çara dyshemesh dhe u prezantuam. Pa dyshim për Zefin kishim dëgjuar mjaft historira, ndoshta ndonjëri ia njihte edhe fytyrën, ndërsa unë për ta isha krejt i panjohur.

- Në ishull gjetëm këta shokë, po rradhis emrat e tyre: Maqo Çomon, Xhavid Qesen, Pëllumb Dishnicën, Filip Jakovën, Spiro Gjokën, Agron Çoratin, Qamil Dishën, Zafer Vokshin, Foni Thanon, Nuri Hutën, Iliaz Ahmetin, Kadri Hoxhën. Pak më vonë erdhën e u bashkuan me ne: Gjin Marku, Vaso Marko, Kasëm Trebeshina, Muedin Kadareja, Kristo Budo dhe një Abdullah, që për fat të keq nuk më kujtohet mbiemri i tij. I kërkoj ndjesë nëse është gjallë.

- Ky Abdullahi ishte paksa enigmatik, fliste rrallë, kishte qenë i internuar edhe në "Goli Otok", në atë ishull famë keq të Jugosllavisë. Herë - herë, buzë mbrëmjeve shtrihej në lëndinë dhe ia merrte ndonjë melodie të ëmbël sllave: Na kishte treguar për regjimine egër të atij regjimi famëkeq, por asgjë më shumë...

- Fola pak për Abdullahin, sepse Zefit aq njerëzor, i vinte më shumë keq për fatin e zi të Abdullahit, sesa për fatin e tij të mbrapshtë.

- "Po më vjen shumë keq për të më thoshte herë pas here Zefi dhe shumë larg prej njerëzve të tij."

- Kur ngrihem nga gjumi për-

shëndesnim njëri - tjetrin me shprehjen e ëmbël "mirmëngjes", por Zefit ia bënin këtë përhëndetje më ëmbëlsisht dukë i shtuar shprehjes edhe emrin e tij: "mirmëngjes Zef".

Ai e ndiente këtë ngrohtësi, vendoste buzën në gaz, na e kthente përgjigjen me



zërin e tij të ëmbël dhe shtonte pa merak.

- "A po na e piqni atë kafe?"

- I shijonte kafja me shokë, sidomos me Filipin, Maqon, Xhavitin, Pëllumbin, Spiron, Agronin, Vason, e të tjerë.

- Mandej tërhiqeshim bashkë në oborr dhe duke ndenjur në njërin prej stolave të guzhinës më jepte mësimin e gjuhës italiane. Ju desh vetëm një laps, një fletore dhe një libër, me kujtime nga burgun, të një anëtari të Partisë Komuniste Italiane, që siç më kujtohet na e fali Pëllumb Dishnica, se sa për memorien, atë Zefi e kishte të shkëlqyer. Për 11 muaj më dha çelësin e kësaj gjuhe të bukur në dorë, për të provuar veten dhe mua nëse kishim arritur suksesin më vendosi direkt në provë me leximin e librit brilant "Jetë Paralele": të Plutarkut. Tash e tutje, më thotë, ec me këmbë tua. Na duhej të kalonim edhe dy orë të tjera të ditës; për t'a mrekulluar i lexova romanin e Tolstoit "Lufta dhe Paqja".

"Kqyre thoshte Ai, sa i madh është Leon Tolstoi, ve re me kujdes personazhet e tij."

- Veçanërisht admironte Natashën dhe sidomos Marian, motrën e Andreas.

"Eshtë një ëngjëll, klithte Zefi, çfarë zemër, asht vet "ShënMëria" e zbritur prej qiellit."

Kishte njohuri të plota për letërsinë

italiane, ruse, fanceze, angleze dhe gjermane. Kur ra tërmeti në rrethinat e Vlorës i nxori jashtë përdorimit godinat e manastirit, ne na u desh t'a kalonim atë dimër të ashpër në oborrin e manastirit në çadra. Improvizuam disa krevatë me dërrasa dhe kur binte ai "shiu i uruar" me rrebesh na

kalonte uji për rrua përposh krevatëve. Në këtë kohë Zefi vuajti shumë, ankohej nga reumatizma.

- Shpesh mënjanohej nga shoqëria dhe ecte poshtë e lart ajatit të kishës; kushedi se çfarë bluante me mendjen e tij racionale. Më pas na tha se do t'i vihej punës për një traktat filozofik dhe ia arriti qëllimit. Ehodhi vetë në letër me një shkrim me gërma tejet të vogla dhe e mori me vete kur u lirua bashkë me të tjerët nga ishulli në vitin 1964.

- Shumicës prej nesh sipas rregullores së komandës na vinin familjet në takim. Fillimisht i lejonin të takoheshin brenda në ishull, se më vonë ato i bënin matanë ishullit, pranë komandës, në një barakë të improvizuar për këtë qëllim; kuptohet edhe për të na përgjuar bisedat me aparatura të vendosura aty.

- Një herë erdhi të më takojë brenda në ishull, nëna. E gjithë gjindja e rrethoi me dashamirësi

dhe i thanë të mos kishte aspak merak për mua, sepse kujdeseshin të gjithë edhe për faktin se isha më i riu në moshë. Më i veçantë në këtë drejtim qe Zefi, duke i shtuar dhe këto fjalë.

- "E ke këtë bir të vecantë, të të rrojë, mos u ban aspak merak se, së shpejti do ta kesh në shtëpi".

- Nëna u përplot dhe ua ktheu këtë urim me zemër të gjithëve. Zefi i shprehu asaj edhe një dëshirë, meqënëse ishte me banim në Korçë, të mendohej se mos i takonte dy vajzat e tij, ti përfaqonte për të dhe tu thosh se baba i tyne i don shumë, mendon për to dhe asht gjallë dhe ndodhet në ishull.

- Jam i lumtur që nëna ime e mirë dhe e dhëmsur mund t'ia plotësojë këtë dëshirë Zefit. Në njërën prej rruqicave të Korçës, ku banonte asokohe familja e Zefit kishte takuar njërën prej vajzave të tij, në mos gaboj atë më të madhen dhe ia kishte thënë ato fjalë të ngrohta një më një.

- Herë pas here shëtisnim bashkë në njërën anë të pyllit, (në anën e majtë që na e kishte lejuar komanda) dhe atëhere vlonte debati.

- "Zef, i thoja, si mendon a do të marrë fund ky debat i pështirë ideologjik, që po na marron?"

- "Jo vetëm që s'ka për të marrë fund

shpejt, por do të vazhdojë gjatë dhe shumë më i ashpër.

S'ka më unitet në kampin socialist, ai po shkapetet dhe shkërmoqet; Kina nuk është budalle që të kthehet ma mbrapa nën tutelën e Bashkimit Sovjetik. Këtij ju tronditën themelet në Kongresin e 20-të. Kina ka figura potenciale politike, i d e o l o g j i k e, ekonomike, siç janë Li Çao Çi, Çu En Lai dhe Ten Siao Pini. Mandej duhen llogaritur qëndrimet e Palmiro Toliatit, i polakëve, i Çekosllovakisë, i Hungarisë, pozicioni i Titos nuk do të ketë më unitet. Shtoj, se edhe kinezët, kinse bajnë se janë miq me PPSH e Enver Hoxhës, Mehmet Shehut e Hysni Kapos".

- Njëherë tjetër e sollën bisedën tek konflikti në "plazhin Zhiron" për Kubën e Fidel Kastros, Zefi mu shpreh kështu:

- "Eshtë mirë që Kenedi i dha fjalën e nderit si president i Amerikës, udhëheqjes sovjetike, se nuk do ta prekte Kubën, në rast se ata tërhiqnin raketat prej atij ishulli. Dhe Hrushovi bukur e bani, u tregua i matun dhe i squtë, që i tërhoqi ato. Shpëtoi bota nga një katastrofë e sigurtë atomike".

- Më vinë ndërmend sa e sa biseda të tjera:

- "A duhet, i them, të ribashkohet Gjermania dhe çka do të fitojë bota prej zgjidhjes së këtij problemi?"

- "Pa dyshim, ma ktheu i vendosur, që duhet ribashkuar dhe ajo do të bëhet pa da një ditë, nuk luhet gjatë me kombin gjerman, çelësi për këtë është në duart e sovjetikëve dhe ata s'duhet me u sjell si kuajt në "lëmë", duhet ta zgjidhin këtë problem dhe aterë bota ka me marrë frymë lirshëm".

- Një mëngjes maji shkova në pyll fillikat për të bërë një shëtitje. Shëtitja gati për dy orë duke rëndur poshtë e lart. Më shkoj ndërmend një vajzë moskovite në hollin e vallëzimit të parkut me emrin e Maksim Gorkit, veshur një fustan të zi me shiritin e bardhë që i rrethonte qafën e saj të bardhe si bora e dimrit rus; ishte mbështetur në njërin prej kollonave të atij holli. Nuk po më shqitej nga mendja kjo Ludmillë apo Tamarë, e cila e kishte braktisur Moskën dhe nuk kishte shkuar në egzil në Siberi, por kishte erdhur aty tek ne në Zvërnec dhe mu shndërrua në një zanë pylli. E ndjeva se isha zhytur thellë në fantazi, prandaj e lashë shëtitjen dhe zbrita poshtë në oborr, me duhej patjetër të takoja njerëz prandaj hyra në kabanon.

- Të gjithë ishim aty, gjithkush në shtratin e vet. Mungonte vetëm Zefi. E mora me mend se ai do të ishte në guzhinë dhe ashtu ndodhi. Zefi ishte ulur në stol me krye të varur në gjoks, kur më vuri re, ngriti kokën ngadalë dhe më pyeti, se ku kisha humbur kaq gjatë. Dukej nga zëri që ishte tepër i dëshpëruar. E pyes nëse i mungonte ndonjë gjë, apo mos ishte i sëmurë.

"Jo më thotë, nuk kam kurrë gja". E mora vesh më pas, se atë mëngjes kishte plasur shëri.

- Disa prej gjindjes e kishin akuzuar rëndë Zefin. I patën përmendur procesin gjyqësor të Monarkut dhe i kishin thënë, se ai ishte përgjegjësi kryesor për dënimin e Qemal Stafës, Vasil Shantos, Tuk Jakovës e të tjerë. Sipas tyre, Ai nuk pati



mbajtur qëndrim burrëror në atë proces, e të tjera sllogane kësi lloji. Ata i kishin përsëritur akuzat që udhëheqësit e PPSH-së ia kishin shpërndarë me bollëk nëpë



rmbledhje të oraganizatave të partisë, të Frontit Demokratik, në faqet e historisë të PPSH-së, nëpër auditoret e universitetit. E keqja më e madhe qe, se ky sherr zgjati mjaft dhe na e pat prishur keqas atë harmoni e sjellje dinjitoze, që kishim vitin e parë të qëndrimit në ishull.

- U desh të bisedoja me Maqon dhe me ata shokë, që e kishin hapur sherrin për ti dhënë fund kësaj shamate të kotë dhe të pajtoheshin me Zefin. Zefi fillimisht nguroi, nuk ia kishte aspak qejfi për t'u pajtuar dhe sipas mendimit tim kishte plotë-

sisht të drejtë, akuza që i bëhej ishte e kotë, sepse këtë e vërtetojnë faktet; jo vetëm se Zefi u dënua më rëndë nga të gjithë, me dhjetë vjet burg, jo vetëm që mbrojti me dinjitet bindjet dhe pikëpamjet e tij dhe të grupit që ai përfaqësonte dhe drejtonte, por se dhe arrestimi i tij ishte nga të fundit, që u arrestua në atë proces. Si u mendua ra dakort që të pajtohej. Pajtimi, me sa më kujtohet u bë duke kremtuar të gjithë së bashku vitin e ri 1963.

- Kur Kasëm Trebeshina iu drejtua autoriteteve për t'ia liruar nga internimi, se në të kundërt do të shpallte grevën e urisë, siç edhe ndodhi. Ai nuk i dëgjoi këshillat e mia për të mos e bërë atë hap, se nuk mund të kushtonte shumë shtrënjtë; atëhere pjesa më e madhe e të dënuarve u vu në lëvizje. Unë u këshillova me Zefin dhe i shpreha mendimin tim për ti bërë presion autoriteve që të mos e lenë aty Kasëmin, prandaj edhe të shpallnim edhe ne bashkë me Kasëmin grevën e urisë në mbështetje të tij. Zefit iu desh të mendohëj se; ai ishte i regjur me kësi gjërash dhe i pjekur politikisht; së fundi dolën krah mendimit tim dhe ishte i gatshëm që të futej dhe ai në grevë me ne. Por unë; Maqoja dhe Kadriu nuk e lejuam për shkak të moshës. Edhe pse ky hap mund të na sillte prangat në duar, ja mbërritëm qëllimit. Në të pestën ditë të grevës, Kasëmin e hoqën nga ishulli, pavarësisht se atij i duhet të bënte dhe një grevë tjetër më të rëndë, prej 17 ditësh pa t'a largonin nga ishulli.

- Në muajin maj të vitit 1964 pjesa dërmuese e të internuarve do të liroheshin. Në ishull mbetën vetëm 4 persona, Maqo Çomo, David Qesja, Gjin Marku dhe Kristo Budo.

- Ndër të liruarit ishte edhe Zefi me Vaso Markon, me të cilët udhëtova deri ne Fier. Për mua lirim nuk pati ishte marrë një vendim, që të shkoja në Memaliaj të Tepele-nës, për të plotësuar dënimin prej 5 vjetësh. U përqafova me Zefin dhe Vason, u urova rrugë të mbarë dhe pak fat në jetën e tyre të mëtejshme, Zefi më porositi që të isha tepër i vëmendshëm, të ruhësja prej provokatorëve për të mos u prangosur dhe shprehu mendimin edhe pse do t'a kisha shumë të vështirë atë masë dënimi, do të gjeja forcë në vetvete për të qenë i squtë për të përballuar vështirësitë me burrëni.

- Doli profetësia ime dhe e Zefit. Ai me të vërtetë pak fat pati në jetën e pas Zvërnecit. Së bashku me Vason, Kasëmin dhe Kristo Budon u ra shorti i mbrapshtë.

- Ishin dënuar edhe me 10 vjet burg për agjitacion dhe propagandë dhe i sollën aty tek ne në burgun e Ballshit.

- Në këtë kohë, Zefi e kishte humbur krejtësisht pamjen, ishte zhytur në errësirën e përtejme. Vetëm një pjesë të kohës e kalonte me mua, se mëngjeseve dilja në punë. Shëtisim bashkë. Përsëri i lexoja "Luftën dhe Paqen" e Leon Tolstoit edhe pse pata paralajmërime nga operativi i

kampit për ta braktisur shoqërinë me të, unë nuk u frikësova, nuk ua vura veshin paralajmërimeve dhe vijova të shoqërohesha me të deri në fund. Zefi edhe pse në ato kondita tepër e tepër të rënda nuk u ligështua aspak, e rrojti deri në fund optimizmin, shpresën se do të vinte ajo ditë e lume kur të shëmbej diktatura dhe ne të gjithë do të gëzonim lirinë. Zefi nuk ia mbërriti asaj dite. Ai u sëmur rëndë me kancer kur e tërhoqën nga Ballshi për t'a çuar në spitalin e burgut në Tiranë, u ndamë së bashku të mallëngjyer.

"Ja pra i dashur Foto, më thonë, idetë e mia unë i vulosa me jetë".

- Zef Mala i besoi zemrës së tij, jo para Korçës së gjykimeve, i besoi ndërgjegjes dhe mbi të gjitha mendimit të tij të lirë. Zefi ishte stoik, kishte transparencën e mendimit, mprehtësinë e gjykimit, një kampion ndër këto fusha dhe s'ka njeri për rival. Ketu duhet kërkuar thelbi i temperamentit të tij. Të krijohet bindja e plotë, që ky burrë me karakter kaq të fortë mbeti besnik i idealeve të veta.

- Kur priftërinjtë katolikë, që i qëndruan edhe ata pranë i kërkuan, që të pendoheshin për bindjen e tij përpara Zotit. Ai nuk e pranoi pendimin. Nëse dikujt nuk i ka pëlqyer hirësia e së vërtetës, të cilin e shpalli vazhdimisht Zef Mala dhe u munduan t'ia hedhin qyrkun e fajit mbi të, kjo gjë as që e vuri në pozitë të vështirë Zef Malën. Idhujt, për të cilët ai nuk bënte kompromis ishin drejtësia e vërtetë, sinqeriteti, një shoqëri e drejtësisë sociale dhe vetësakrifikimi. Joshjet, kërcënimet publike, shantazhet, internimi, burgu nuk e përkulën atë, nuk ia mbyllën gojën për të thënë atë që ndiente thellë në shpirtin e tij të pastër. Këtë e vërteton më së miri "Promemorja" e tij dërguar Kryesisë së Këshillit të Ministrave, Mehmet Shehut, Kryeministër i asaj kohe.

- Me trashëgiminë e Zef Malës duhet të merren njerëz kompetentë dhe t'i japin vendin e merituar në panteonin e të gjithë atyre burrave të historisë sonë kombëtare, që u bënë fli për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Burimi: Gazeta
"KORÇA" shtator 2010

Foto Proko gazetar, ka lindur në qytetin e Leskovikut në vitin 1938, u nda nga jeta me 14 nëntor 2015. Ai u shkollua për gazetar në BS, u martua me një ruse, me të cilën i lindi një vajzë. U kthye në Shqipëri për dy vite dhe këto vite punoi si gazetar në Radio Tirana. Sapo u prishëm me BS ai u nda nga gruaja, e cila mbeti në Rusi, ai u internua për 13 vite, më pas u burgos për agjitacion e propagandë 10 vite.

Viti 1990 e gjeten në internim, me gjithë familjen në thellësitë malore të Gores së Korçës në pune si minator. Ai kaloi një jetë me vuajtje dhe persekutim nga diktatura komuniste. Vuajti vetëm sepse mbrojti gruan dhe vajzën e tij, familjen e tij, të cilën e kishte të shenjtë. Pas 32 vite, ai arriti të takojë vajzën edhe gruan e tij moskovite

Përgatiti për botim:
Gjon Fierza, Prill 2019

BASHKËSIA DUKAGJINASE NË LEZHË

Lezha në përgjithësi këto dhjetë vjecarët e fundit ka pësuar një rritje të popullsisë. Të ardhurit janë nga rrethe të ndryshme të vendit. Kryesisht nga zonat veriore. Në mes të këtyre bashkësive të ardhur janë edhe nga treva e Dukagjinit.

Është pozitive fakti, se ashtu si ata të cilët kanë ardhur në kohën e monizmit, kanë bërë emër të mirë. Periudhë, ajo ku ishte privilegj të punoje në rrethin e Lezhës.

Të tillë mund të përmendim familjen e Tomë Gjonit-Vocaj, në Zejmen; Dede Marashit, në Shënkollë; Mark Shalës në Tale; Zef Markut dhe e Gjon Gurit, në Rrilë e të tjerë. Gjeografia e të ardhurve është nga të gjitha fshatrat e Dukagjinit, duke filluar nga Thethi deri në Prekal e nga qafa e Boshit deri në qafën të Agrit. E thënë më saktë nga çdo fshat i Dukagjinit. Kjo bashkësi është e respektuar, madje është përshtatur më së miri me banorët vendas dhe bashkësitë e ardhura. Kom-

binimi i kulturave, zakoneve, traditave, ka arritur sa tani po zbehet fjala “të ardhur”.

Sot, dukagjinasi ashtu si ç’ kanë qenë edhe janë të integruar në të gjitha institucionet, në biznese e organizata jo qeveritare. Kjo traditë është ruajtur që nga koha e monizmit. Nga bashkësia Dukagjinase në Lezhë, ka pasur kuadro të rëndësishëm në drejtim të tillë të përmendim, Mhill Marku, deri në detyrën e Z/ Ministër i Punëve të Jashtme; Vat Braka, Sekretar i Komitetit ekzekutiv të rrethit; Dede Marashi drejtues në shumë ndërmarrje e kooperativa bujqësore e të tjerë. Janë me dhjetëra e dhjetëra kuadro të lartë, madje edhe me mastera shkencor, që kanë punuar e punojnë në sektorë të ndryshëm si në ushtri, polici, drejtësi, ekonomi, shëndetësi, arsim e të tjera. Duke kërkuar falje për disa, që nuk mund ti kujtojmë.

Të tillë janë, Dede Marashi, Fran Marku, Gjergj Voci, Tonin Voci, Ndue

Ziçi, Mirash Ftoni, Gjini Stenaj, Bal Musheqi, Prel Guri, Nosh Ndrezhaj, Ndok Marku, Martin Delia, Lulash Marku, Nikoll Gjergj Pali, Shan Gërdhata, Gjon Guri e të tjerë. E rëndësishme është, se ku do ku kanë punuar e punojnë, janë të nderuar e të respektuar.

Dukagjinasi, të cilët banojnë në Lezhë ka edhe biznesmenë të nderuar, të cilët i japin shtytë zhvillimit ekonomik të zonës, që në mes të cilëve mund të përmendim Vëllezërit Lamthi, Alban Ziçi, Arben Marashi, Vëllezërit Fusha, Agim Voci, Gjini Vuksani, Vëllezërit Marku e të tjerë.

Ashtu si ka qenë dhe është krenar për djemtë, vajzat, burrat e gratë e kësaj treve. Është krenar për Dukagjinasi, të cilët banojnë e punojnë në rrethin e Lezhës.

Në këtë shkrim, ne u ndalëm te një pjesë të kuadrove e specialistëve të elitës tyre. Po ka me dhjetëra mësuese, mjek e infermier, të cilët japin kontributin e tyre në këta sektorë.

Bashkësia dukagjinase, është e shpërndarë në të gjitha krahinat e Lezhës, që mund të llogaritim, se janë mbi 1500 banorë. Pra, gëzojnë respekt nga banorët vendas dhe nga bashkësitë e tjera. Nuk kanë probleme me shtetin e as me banorët. Por janë integruar më së miri me kulturat, zakonet e traditat e të tjerëve. Gjithashtu kanë transmetuar edhe kulturën, traditën e zakonet e mira të trevës prej nga kanë ardhur. Duke i harmonizuar me ato të bashkësive, që i rrethojnë.

Në një takim të organizuar me bashkësive dukagjinase, në mes të tjerëve, Gjok Vuksani nga fshati Lekaji i krahinës së Shalës, tha: “Ne duhet të punojmë më shumë me rininë, për tu transmetuar tradita të mira të kësaj treve, e cila tani është “Nderi i Kombit”, siç janë besa, burrëria, bujaria dhe mbi të gjitha dashurinë për trevën e Dukagjinit e të gjithë Shqipërinë. Pra, duhet të transmetohen brez pas brezi, që të mos harrojnë asnjë herë prejardhjen e tyre.

Nikoll Gjeshi, Balldre-Lezhë

PJETËR SMAKA, ME KONTRIBUTE TE RËNDESISHME PER ARSIMIN NË DUKAGJIN DHE NË MALËSINË E MADHE


Disa ditë më parë, në qytetin e Koplikut, u nda nga jeta në mënyrë të papritur, në moshën 72 vjeçare, një mik e dashamirës i dukagjinaseve, Pjetër Smaka, i cili një jetë të tërë ja kushtoi zhvillimit dhe konsolidimit të arsimit në Dukagjin dhe në Malësinë e Madhe. E kam njohur nga afër si koleg e drejtues për shumë vite, prandaj ndjeva obligim për të shkruar diçka për të, në gazetën “Dukagjini”, lexues i rregullt i të cilës ishte.

Punën fisnike të mësuesit e filloi në Dukagjin, në fshatin Abat të Shalës. Aty formoi edhe familjen me bashkëshorten, Mrin, e cila u nda nga jeta shumë shpejt. Në fillim ishte mësuesi në pastaj drejtor i shkollës 8 vjeçare “Ura e Re”, në Lotaj.

Kishte aftësi profesionale e shkencore dhe shumë i komunikueshëm me nxënësit, prind, koleg e vartës. Ishte i suksesshëm në metodologji ku nxënësin e konsideronte objekt e subjekt të mësim-it, i aftë për të ngulitur tek nxënësit njohuritë shkencore në lëndët historike e gjeografi, duke rritur cilësinë e të nxënësit, larg pedantizmit. Kishte aftësi të rralla në komunikim me njerëzit, i dashur, hokatar, sportiv dhe bashkëpunues. Prandaj donin të gjithë, të pinin një kafe me të, t’u shkonte dhe t’i priste në çdo kohë. Krahas punës, duke qenë shumë vital e këmbëngulës, punoi pa u lodhur për shtimin e njohurive shkencore e profesionale, duke përfunduar shkollën e lartë pa shpëputje nga puna, në degën historike - gjeografi. Me punën dhe sjelljen e tij, fitoi respektin e shaljanëve, me të cilët nuk i shkëputi kontaktet asnjëherë.

Mbas largimit nga Dukagjini punoi në drejtimin e shkollave të ndryshme në Malësinë e Madhe dhe shumë vite drejtor i zyrës arsimore, i cili, me përkush-

timin dhe kompetencën profesionale të tij, i dha një hop cilësor gjithë arsimit në këtë rreth, duke qenë i çliruar nga çdo ndikim partiak. Nuk largoi njeri nga puna, përkundrazi ishte i prirur vetëm për të bërë mirë. Mikpritjen, bujarinë dhe respektin që gjeti në Dukagjin jua shpërbleu duke punësuar me dhjetëra më-



sues nga zonat ku punoi, të cilët gjetën mbështetjen e tij për punë, me largimin e tyre në zonat urbane apo rreth tyre për një jetë më të mirë, mbështetje, të cilën nuk e gjetën në rrethin e Shkodrës. Për këtë të gjithë i janë mirënjohës tërë jetën.

Në të gjithë Malësinë e Madhe e më gjerë ishte një personalitet me besueshmëri të lartë, i cili gëzonte respektin e të gjithëve. Tek Ai, ishin harmonizuar vetitë e virtutet më të mira të malësorit.

Ishte shumë bashkëkohor, përkrahte ndër të parët të rene e progresin. Sa i dashur dhe i çiltër me të gjithë, Ai ishte edhe shumë kritik ndaj mangësive që shikonte. Ishte shumë konstruktiv dhe nuk e kursente ndihmën për eliminimin e mangësive, sidomos ndaj mësuesve të rinj duke i vënë në pozita pune. Ishte i vetmi drejtues arsimit që i vlerësonte realisht punën e secilit, i stimulonte dhe bënte veprimtari çdo vit me mësuesit e dalluar. Ishte objektiv në vlerësimin e ndryshimeve të dekadave të fundit dhe shumë kritik ndaj shumë plagëve që koha i solli. Ishte ndër të rrallët njerëz me funksione të larta i pa korruptuar. Edhe më e pas ndërmend me të krye punë, me i përmend një kafe, puna mbetej pa u krye.

Jetoj me djersën e ballit dhe la aq pasuri sa mund të vihet nga një rrogë shteti.

Ishte edhe një prind shembullor. Ai, bashkë me bashkëshorten, Mrin lindën, rritën dhe edukuan katër fëmijë të mrekullueshëm: Ilirin, Irenën, Linditën e Mirën, të cilët kanë krijuar familjet e tyre. Ju urojmë që të gjejnë forcë për ta përballuar humbjen e njeriut të tyre më të dashur, për të cilin duhet të jenë krenar tërë jetën.

Për punën e mirë dhe kontributin e dhënë në shërbim të arsimit në Dukagjin e më gjerë, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” e ka nderuar Pjetër Smakën me titullin “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, me motivacionin: “Për devocion e përkushtim të përherëshëm në fushën e arsimit dhe ngritjes së nivelit kulturor të bashkësisë dukagjinase”. Me keqardhje e shkruaj, se Pjetër Smaka nuk mori vlerësimin që meritonte nga pushteti vendor apo drejtuesit e arsimit në Malësinë e Madhe.

Kush ishte, çfarë vlerash ka pasur dhe

sa autoritar ka qenë Pjetër Smaka, e tregoi përcjellja që iu bë për në banesën e fundit nga koleg, ish nxënësi, shokë e miq të shumtë të tij, ku të krijohej përshtypja se nuk kishte mbete njeri në Koplík, në tërë Malësinë e më gjerë pa marrë pjesë në lamtumirën e fundit të tij.

Disa opinione:

Pashko Blinishta: “Pata fatin të punoj me të, në Shalë e në Malësinë e Madhe. E pata shok e mik, më është gjendur pranë në ditë të vështira dhe nuk e ka kursyer një send për mua. Nuk përtonte edhe të kritikonte dhe isha i ndërgjegjshëm, se kishte të drejtë. Do ta ndiejmë shumë mungesën e tij”.

Sherif Zeka: “Humbëm shokun më të mirë. Ishte shpirt njeriu. Mu ka gjendur pranë kur kam pas nevojë. Ishte shumë human dhe i komunikueshëm”.

Ndue Gjonaj: “E njoha nga afër në Dukagjin edhe Koplík, duke bashkëpunuar me të në sektorin e arsimit dhe organizatat shoqërore. Ishte shumë korrekt dhe i vendosur në kryerjen e detyrave, si dhe i papërtueshëm me u përballë me pengesat në punën e tij”.

Rifat Isufi: “E pata koleg dhe epror shumë vite. Kishte aftësi të veçanta drejtuese dhe organizative, i cili me punën e tij dhe aktivizimin e vartësve, i dha një hov të ri arsimit në Malësinë e Madhe, duke e vënë në pozita bashkëkohore. Ishte shumë bashkëpunues”.

Do të kujtohet shumë gjatë me respekt për punën e tij kudo ku punoi, për vlerat shoqërore e njerëzore, ku brezi i ri duhet ta kenë model në punën e jetën e tyre.

Me vdekjen e tij të papritur, familja humbi njeriun e tyre të dashur, shoqëria shokun e tyre më të mirë kurse Koplík e Malësia e Madhe intelektualin dhe kuadrin e tyre të devotshëm, i cili nuk kurseu asgjë në shërbim të arsimit dhe bashkësisë.

Përgatiti PRELË SHYTANI

20 VJET SHOQATA E VËLLAZËRISË KOSOVË - MALËSI E MADHE “MARTIN DRESHAJ”

Me 12 prill 2019 në Pejë, Shoqata e Vëllazërisë Kosovë – Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”, me qendër në Pejë, dhe Komuna e Pejës, organizuan Manifestimin tradicional kulturor “ZËRI I VËLLAZËRISË - 2019”, që ishte takimi në përkujtim të rënies heroike me 12 prill 1999, të dëshmorit Shaqir Ramë Tahiraj.

Takimi nisi në fshatin Fierzë (ish Novoselë) ku u bënë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve dhe u vunë kurora lulesh, në nderim të rënies heroike të Shaqir Ramë Tahiraj, të gjithë luftëtarëve dhe martirëve të kombit.

Pastaj në Teatrin “Istref Begolli” në Pejë, organizohet mbrëmje kulturore e artistike, folklorike. Manifestimi nisi me himnin kombëtar dhe një minutë heshtje për dëshmorët e rënë në të gjitha trojet shqiptare.

Moderator i këtij manifestimi ishte Fadil Grabovci, një anëtar shumë vjeçar i shoqatës Hapjen e bëri kryetari Ukshin Jashari, i cili në mes të tjerave theksoi: “Pasi falënderoi pjesëmarrësit në këtë veprimtari kaq të madh, duke shkuar ne fillimet e saj, Shoqata veprimtarinë në fillimet e bashkëpunimit me shoqatat nga Malësia e Madhe, si me Shoqatën “Ilirikum”, Shoqatën “Gruda” me Shoqatën “Rrapsha e Hotit”, me Ansamblin “Shqiponja”, me Shoqatën “Dedë Gjon Luli”, për të zgjeruar veprimtarinë në Plavë e Guci, që për disa vite bashkëpunuam me Ansamblin “Majat e Karafilave” dhe me veprimtar nga Rozhaja, Ana e Malit e nga Ulqini, të cilët gjetën një mbështetje vëllazërore në Shoqatën tonë, për ti bërë ballë asimilimit të egër që po ushtronte Podgorica mbi popullatën autoktone shqiptare”.

Frashër Racaj, Sekretar i përgjithshëm i Shoqatës, ndër të tjera theksoi: “Shoqata jonë këtë vit po shënon 20 vjetorin e themelimit dhe të veprimtarisë së suksesshme ku bashkëpunon me Malësinë e Madhe, Shkodrën, Plavën e Gucinë, Rozhajën, Ana e Malit, Ulqinin, Kosovën Lindore e me vise tjera të Shqipërisë. Shoqata jonë bashkëpunon edhe me bashkësinë shqiptarë në Detroit e në Nju – Jork, ku malësorët kontribuojnë dhe veprojnë për çështjen e pazgjidhur shqiptare. Njëherësh i falënderojmë fort për mbështetjen financiare që i ofrojnë shoqatës sonë. Për të përshkruar veprimtarinë 20 vjeçare të Shoqatës duhet një libër i tërë, rrugëtimin e veprimtarisë nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe jehona e manifestimit “Zëri i Vëllazërisë” kudo që jetojnë shqiptarët ka bërë ndikim pozitiv të bashkëpunimit dhe ruajtjes së vlerave kombëtare”.

Fjalime përshëndetëse mbajtën, Ndue Sanaj – Kryetar Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, i cili në mes të tjerave u ndal: “U bënë shumë vite, që dal në këtë tribune të nderuar e përshëndes në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Sigurisht, në secilin rast e kam ndjerë veten të privilegjuar, por kjo e sotmja është



pak ndryshe. Është ndryshe, se Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe, e pagëzuar me emrin “Martin Dreshaj”, ka 20 vjetorin e themelimit të saj dhe unë, me këtë rast ju përshëndes dhe ju

uroj Gëzuar anëtar e anëtare të Shoqatës së Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”!

I gëzofshi 20 pranverat!

Urime dhe më me shumë arritje në të



ardhmen!

Nëpërmjet bashkëpunimit me ju, kemi krijuar miqësi dhe kontakte me njerëz të artit, të kulturës dhe të politikës në shumë qytete të Kosovës. Të gjithë i përshëndes, por me këtë rast, dua të përshëndes veçanërisht përfaqësuesit e bashkësive komunale në Pejë, Shkoderaj, Klinë, Istog, Deçan, Prizren, Ushtri, Podujeve, Mitrovicë e Rozhaj, të cilët na kanë mirëpritur, vlerësuar dhe respektuar në mënyrë të veçantë!

Në këtë festë kam ardhur me një grup të veçantë nga herë të tjera, me një grup të nxënësve të shkollës 9 vjeçare, në Shkodër, që mban emrin e heroit të madh të Kombit tonë, që me 6 prill 1911 ngriti Flamurin e Gjergj Kastriotit, pas gati pesë shekujve, në malin e Deçit, Dede Gjon Luli, kam këtu drejtorin e kësaj shkolle, zotin Gjovalin Kodra, N/drejtoreshën e kësaj shkolle, zonjën Tule Ahi dhe mësuesen e edukimit, zonjën Drita Zefi. Gjithashtu kam ardhur me miqtë e vjetër të juaj, zotin Aleks Dushi, me themeluesit e shoqatës Prele Shytani e Kole Çardaku, e publicisten Roza Pjetri; me një nder kontribuuesit e mëdhenj në realizimin e misionit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe publicistin e poetin Lulash Brigja.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, është krenare që ka zënë një mik si ju, që ju për një 20 vjet i keni shërbyer jo thjeshtë Kosovës, por në këto 20 vite i keni shërbyer kombit tonë dhe së bashku për dhjetë vjet, që punojmë të bashkuar në art e kulturë kudo, në gjithë Rrafshin e Dukagjinit, këtu në Kosovë, në Shkodër, në Tuz, në fshatin Lekaj të kësaj komune, ku jeton dhe i shërben kombit tonë, i madhi Shtjefen Ivezaj. Në Rozhajë, ku kemi njohur një tjetër flamurtar të çështjes kombëtare, vëllain e nderuar Ali Daci. Kudo dhe kurdoherë me moton “Jemi vëllazër, qeshim e qajmë së bashku!”, sepse jemi një komb, kemi një gjuhë, kemi një flamur dhe kemi një histori të përbashkët. Së bashku me ju punuam gjatë dhe do të vijojmë të punojmë me idenë e madhe, me idenë e madhe historike, atë të bashkimit të kombit shqiptar pa u ndalur për asnjë çast.

Ju, të nderuar anëtar e anëtar e të kësaj shoqate keni qënë frymëzim për ne, sepse me idenë tuaj për të shtrirë veprimtarinë tonë në gjithë Trevat Shqiptare, në këto vite po të thuash vepruam pa u ndalur dhe do të vijojmë pa u ndalur në realizimin e misionit tonë pavarësisht vështirësive, që kemi pasur dhe mund të kemi, çka është normale si për ne dhe për ju, se nuk është e lehtë të punohet vullnetarisht dhe të kuptohet ky vullnetarizëm. Kryesisht vështirësitë janë financiare, për të realizuar ëndrrën tone, por duke u mbështetur nga biznesmen e intelektual të fushave të ndryshme dhe nga pushetëti vendor, drejtuesit e së cilës janë të suksesshëm e dinë, e vlerësojnë, dhe e kanë mbështetur dhe do të na mbështesin shoqërinë civile, në realizimin e misionit tonë. Gjithashtu, dhe biznesmenët bujarë dhe zemërmirë e kanë kuptuar, se duke

financuar misionin e shoqatave civile, nuk humbin, por fitojnë bekimin e Zotit dhe mirënjohjen e kombit!

Ju uroj, që kështu të ecim, me këto ambicie edhe në të ardhmen!”

Përsëritet, Rexhep Abazi, kryetari i grupit folklorik “Shpëtimi” Medvegje;

Fatmir Hasani, deputet shqiptar në Parlamentin e Serbisë;

Pal Dreshaj, Tuz, vëllai i Martin Dreshaj, që mban emrin e tij kjo Shoqate.

Vesel Nikçi, kryetari i Ansambli Folklorik Autokton “Rugova”.

Të gjithë e uruan për 20 vjetorin e punës shoqatën nikoqire, duke u zotuar se dhe në të ardhmen do të bashkëpunojnë me këtë shoqatë, në cilin do qytet vetëm e vetëm, të mbrohet kombi ynë.

Shikuesit në këtë manifestim patën rastin të shikojnë pika artistike të vlerave kombëtare, me fyell, çifteli, lahutë, kavall si dhe recitim, valle tradicionale dhe muzike popullore nga grupet folklorike:

Shoqata Atdhetare “Dukagjini” Shkodër, Ansambli Folklorik Autokton “Rugova” Pejë, Grupi “Shpëtimi” Medvegje, Shoqata Kulturor Artistike “Shote Galica” Drenas dhe Grupi Folklorik “Petralba” Klos. Si dhe këngëtar të mirënjohur të estradës folklorike si Rifat Berisha, Gjon Kosteri, Rexhep Abazi, Xhemajl Berisha, Bardhe Tushaj, Fatmir Berisha, Jasmin Nikaj dhe Ismet Demaj.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, ka dhjetë vite që merr pjesë në veprimtaritë e përbashkëta me këtë shoqatë, në muajin prill të çdo viti. Por, këtë radhë morën pjesë me një grup të nxënësve 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, në Hot të Ri, me drejtorin e kësaj shkolle, zotin Gjovalin Kodra dhe personel mësimit të kësaj shkolle.

Këta nxënës janë 9 vetë: Paula Pllumbaj, Denilsona Rrasa, Xhesika Zefi, Pamela Mirashi, Xhovana Bashota, Gjesika Mirashi, Dorjan Rrasa, Valentin Prela e Emanuel Lungaja.

Me këta nxënës u paraqitem me vallen e “Mrizit”; me dy recitime: Dorian Rrasa me poezinë e “Kosova” dhe Pamela Mirashi, me poezinë “Gjuha Shqipe”; dhe me një ekspozitë, me 13 punime piktore, të piktorit të vogël, të klasës së tetë, Emanuel Lungaja.

Të gjithë këta nxënës i falënderoj për punën shumë serioze që kanë bërë me në krye mësuesen Drita Zefi dhe për përgjegjësinë e treguar. Ata u paraqiten si profesionistë të vërtetë. Ju lumtë!

Një prezantim shumë të mirë bëri dhe rapsodi Gjon Kosteri, me lahutë dhe me këngën e madhe, të titulluar “Lahuta Iliriane”.

Me këtë rast, Shoqatës “Martin Dreshaj”, në emër të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, ju dhurua një panoramë në allci “Shkodra”, të cilën e dorëzoi Aleks Dushi, ai që ka bërë të mundur ndërmyshësimin me këtë shoqatë.



Në darkën e organizuar nga kryesia e kësaj shoqate, në hapësirën e restorantit u bë prezantimin i 13 punimeve në pikturë të Emanuelit, i cili kryetarit të kësaj Shoqate, zotit Ukshin Jashari, i dhuroj portretin e tij.

Pastaj u ndanë disa tituj nderi:

Shoqatës sonë, ju dha titulli “Mirënjohja e Shoqatës Martin Dreshaj”, për pjesëmarrjen e mbështetjen, që i kemi dhënë veprimtarive të saj”.

Zotit Sokol Cubi, ju dha titulli “Anëtar i Shoqatës Martin Dreshaj”.

Shkollës 9 vjeçare “Dede Gjon Luli, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”.

Publicistit e poetit Lualsh Brigja, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”;

Rapsodit Gjon Kosteri, ju dha titulli “Mirënjohja e shoqatës Martin Dreshaj”.

Mundësuan pjesëmarrjen, në këtë veprimtari: zoti Sokol Cubi, zoti Mhill

Prioni, zoti Agron Hasanaj, zonja File Strugaci, zoti Kole Çardaku dhe zonjusha Roza Pjetri.

Në emër të kryesisë së shoqatës i falënderojmë për kontributin e tyre, me uroimin popullor “Paçin e dhënçin!” Askujt nuk i tepron pasuria, leku, por askush nuk mund të ndali bujarinë e bujareve!

Ju faleminderit! Zoti jua shtoftë dhe dhënçi për të mira!

Opinionet e nxënësve të shkollës 8 vjeçare “Dede Gjon Luli”, për pjesëmarrjen e tyre në këtë veprimtari:

Valentin Prela: Jam shumë i gëzuar që isha pjesë e grupit artistik të shkollës dhe që përfaqësoja Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”. U gëzova që pashë Pejën e bukur. Ishte shume e bukur. Burimi i Drinit të Bardhe me mbeti në mendje, ishte fantastike. Interpretimi i valles në teatrin e Pejës më fali shumë kënaqësi. Falënderoj mësuesen tonë, që punoj pa u lodhur.

Gjovana Bashota: Udhëtimi për në Pejë ishte shume i veçante. Ne, u argëtuam pa fund. Duartrokitjet në vallen e “Mrizit” na emocionuan shumë. Teatri ishte si një magji dhe gjithashtu burimi i Drinit të Bardhe. Falënderoj Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, që na mundësoj të bëhemi pjesë e grupit përfaqësues të saj. Gjithashtu dhe drejtorin e shkollës dhe mësuesen tone të palodhur, Drita Zefi.

Pamela Mirashi: Ishte udhëtimi më mbresëlënëse, që kam bërë ndonjëherë. Banoret e Pejës ishin shume mikpritëse dhe të dashur. Ishte hera e parë, që unë interpretoj në një skenë teatër, ku duartrokitjet më hoqën emocionet. Falënderoj organizatorët! Respekt për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, që na bëri pjesë të saj.

Dorjan Rrasa: Jam kre-

nar për interpretimin, që kisha në teatrin profesional të Pejës dhe falënderoj publikun e mrekullueshëm të Pejës, për duartrokitjet që më dha. Peja ishte një vend, nuk e imagjinoja kurrë që të ishte aq i bukur, ne veçanti, Drini i Bardhë i jepte një bukurri mahnitëse. Faleminderit mësuesve dhe Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Xhesika Zefi: Ishte një mrekulli pjesëmarrja në një veprimtari kaq të rëndësishme të Shoqatës Vëllazëri Kosove - Malësi e Madhe “Martin Dreshaj”. Emocionet tona vërshuan si Drini i Bardhë. Faleminderit mësuese Drita Zefi, që punove aq shumë me ne! Faleminderit Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, që na bëtë pjesë e juaja.

Denilsona Rrasa: Udhëtimi për në Pejë më la shumë mbresa. Vallja e jonë mori shumë duartrokitje në teatrin e Pejës. Falënderoj drejtorin e shkollës Gjovalin Kodra si dhe mësuese Drita Zefi që punoj qe shumë me ne. Një respekt të veçantë për Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, që na besoi ta përfaqësojmë në këtë veprimtari kaq të rëndësishme.

Paula Pëllumbi: Me ka pëlqyer shumë Peja dhe ishte shumë vend i bukur. Jam shumë krenare, që isha pjesë e valles së “Mrizit” që ne interpretuam. Jam shumë krenare, që isha pjesë e grupit përfaqësues të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”. Respekt e dashuri për mësuese Drita.

Xhesika Marashi: Interpretimi në rolin e bareshës te vallja e “Mrizit”, më fali shumë emocion e kënaqësi. Teatri i Pejës ishte madhështor dhe kishte një publik të mrekullueshëm dhe shumë të dashur. Një falënderim i veçantë për mësuesen Drita. Kënaqësi e veçantë që isha pjesë e grupit përfaqësues në këtë veprimtari, e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Edmond Lungaja: Për herë të parë në jetën time pata fatin të prezantoj, në Pejë punimet e mia në pikturë, Kjo më dha një emocion të pa përsëritur. Ato u panë me kureshtje të madhe nga publiku. Faleminderit drejtorit i shkollës, Gjovalin Kodra. Faleminderit Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, që më bëri pjesë e grupit përfaqësues të saj në këtë veprimtari kaq të rëndësishme dhe publikimin e punës sime. Kjo pjesëmarrje dhe ekspozimi i punës time, do të mbetet në kujtesën time gjithmonë. Edhe një herë faleminderit!

Faleminderit gjithë personelit të shkollës 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, për përfaqësimin tuaj me shumë dinjitet, e cila i dha një përvojë shumë të mirë kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, për të pasur objekt të punës së saj, në të ardhmen në drejtimin të punës sonë për realizimin e misionit të saj, në drejtimin e emancipimit më tej shoqëror.

Përgatiti Luash Brigja



Ç'KATASTROFË PËR MBARË NJERËZIMIN. PARAJA JMËRON SAMITI I TOKËS I O.K.B. - SË NË JOHANESBURG TË AFRIKËS SË JUGUT



Përgatiti
Luigi Temali

Kaluan vite nga Samiti i Tokës, në Johannesburg të Afrikës së Jugut, i organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara me pjesëmarrjen pothuajse të gjithë kryetarëve të shteteve të Botës. Konkluzioni: asnjë masë konkrete për të ndaluar erozionin e madh të klimës në planetit tonë.

Sipas kryeministrit të Britanisë së Madhe Toni Bler: "...Një fëmijë vdes çdo tre sekonda në Afrikë nga uria, sëmundjet apo konfliktet. Ndryshimet klimaterike do të bëjnë që së shpejti të vuajë e gjithë Bota dhe do të shkatërrojë disa pjesë të planetit nëse nuk do të ndalohen paraprakisht..."

Në bazë të statistikave të O.K.B. rreth 800 milion njerëz jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme e të mizerjes. Çdo ditë nga uria, luftërat, fatkeqësitë natyrore, epidemitë etj. ndahen nga jeta 24 mijë vetë.

Zhvillimi i sotëm botëror është një fitore me rëndësi historike për Njerëzimin. Por, nga ana tjetër, ky zhvillim paraqitet i mbarsur me rreziqe të paimagiinueshme. Mbi të gjitha Efekti Serë. Ai po vjen hap pas hapi si një ajsberg gjigand i përmasave të papara për të goditur në një moment të caktuar anijen tonë kozmike Tokë. Kjo tragjedi e ka burimin nga pasojat e një zhvillimi ambicioz e të sforcuar, jo harmonik e të kontrolluar të veprimitarisë së njeriut mbi Natyrën.

Super fuqitë në garën e tyre për hegjemoni kanë ndotur përtej çdo norme të lejueshme ajrin, tokën e ujin e rruzullit tonë me të gjithë llojet e gazrave dhe të lëndëve helmuese, që shkarkohen nga dhjetra mijëra komplekse industriale e qindra milion mjete transporti.

Planeti ku banojmë është i kufizuar në hapësirë e kohë. Ndoshta edhe për disa qindra vjet do të jetë e vështirë të gjën-

det një tjetër në kushte jetese të përafërta me Tokën. Në këtë kuadër Natyra, Dielli, Ajri dhe Uji, si faktorë determinues të jetës, janë pronë e përbashkët e mbarë Njerëzimit.

Këto ditë u ratifikua Traktati i Kiotos së Japonisë, i cili i vuri theksin e ndotjes së ambientit dhe rritjes në 5 % të temperaturës së planetit. Ngrohja globale ka lëvizur drejt shkrirjes së akujve të Oqeanit të Ngrirë të Veriut dhe Antartikës duke sjell prishjen e ekujlibrave të jetës. Efekti i Serës po shkakton përmbetje masive, veçanërisht në zonat e ulëta bregdetare, si edhe mundësinë e afërt për zhdukjen nga harta gjeografike të disa shteteve shumë të vogla të Oqeanisë. Supërfuqitë dhe fuqitë e tjera, veçanërisht SH.B.A., Austalia etj., të cilët janë ndotësit më të mëdhenj, duhet të kontribuojnë urgjentisht dhe me mjete financiare e teknike më të mëdha.

Me 26 dhjetor 2004 ndodhi Apokalipsi i Azisë juglindore ku nga Sunami i tmerrshëm nënujor vdiqën rreth 3 00 000 mijë njerëz. Kjo katastrofë është sinjal i mundësisë së ekzistencës të një "humnerë" misterioze me intensitet veprimi të lartë, e cila ndodhet afër pragut të jetës së planetit tonë.

Fenomeni i Serës ka sjellë pakësimin e azonit të atmosferës duke krijuar disa "vrime të zeza", njëra nga të cilat ndodhet në Ballkan, për depërtimin e rrezeve ultraviolette të Diellit, të cilat janë fatale për çdo qenie të gjallë. Çdo gaz i prodhuar, që shkarkohet në natyrë, "depozitohet" në gjirin e saj. Pavarësisht nga dekompozimi i një pjese, shumica futet në mushkëritë e njeriut dhe të krijesave të tjera duke u bërë burim i shumë sëmundjeve të zemrës, mushkërive dhe kancerove. Për rrjedhojë ajri që thithim bëhet përherë edhe më helmues.

Shkatërrimet masive të pyjeve të Amazonës, Afrikës Qëndrore e vendeve të tjera pakësojnë në mënyrë drastike sasinë e oksigjenit, duke sjell dëmtime të pallogaritshme për të sotmen e të ardhmen e rruzullit tonë. "Pa pyll nuk ka ujë, ngrohje dhe ajër të pastër, nuk ka rreshje shiu dhe klimë të stabilizuar, nuk ka toka pjellore, bujqësi e blegtori të përparuar si edhe mirëqenia e prosperitet të pandërprerë".

Me kalimin e kohës po ndihen gjithnjë e më tepër pasojat negative të ndërhyrjeve shkatërrimtare të njeriut mbi natyrën. Ç'pyllëzimet masive, mungesa e digave dhe e pritave të domosdoshme, shfrytëzimi pa kritere shkencore e norma teknike të materialeve inerte etj. kanë sjellur efekte negative, të cilat paralajmërojnë për fatkeqësi të tjera.

"Shoqëria njerëzore qëndron mbi ujërat, pyjet, tokën, dhe mineralet e dobishme. Nga mënyra se si ne do t'i përdorim për shfrytëzimin e futjen në qarkullim të këtyre burimeve varet shëndeti, siguria, ekonomia dhe mirëqenia jonë."

Shqipëria, në raport me numrin e popullsisë, ka sasinë më të vogël të tokës

në Evropë, 2 dylym për banor. Në këtë kuadër është tepër shqetësues fati që 150000 ha tokë rrezikohen nga ujërat nën dhe mbi tokësore ose siç quhet ndryshe erozioni. Disa fshatra janë shembur nga rrëshqitja e tokës. Të tjerat "presin radhën"! Çdo vit në shkallë vendi derdhen në det 60-70 milion ton dhe një katastrofë e vertetë. Me këto ritme, po nuk u morën masa të menjëherëshme, një ditë do zgjohemi në një rajon pa tokë bujqësore dhe gjysëm të shkretë.

Cili është ai që ka shkuar në Pukë dhe nuk ka ndërjerë dhimbje e trishtim kur ka parë me mijëra pisha të prera dhe shumë male e kodra të çveshura e pa jetë? Nuk janë të pakët ata që kujtojnë me hidhërim e nostalgji kodrat e Rencit, Bardhajve e Tepes të "veshura" me pyje pishe, bredhi, selvie etj, kurse sot.....!

Një fenomen tjetër shqetësues janë mbetjet kolosale urbane, të cilat vazhdimisht ngushtojnë ambientin ku jetojmë duke rrezikuar shëndetin dhe jetën e njerëzve. Mungesa e fondeve të nevojshme si edhe e teknologjive moderne për përpunimin e likujdimin e plotë të mbeturinave po e "mbysin" Botën me "kodra" e "male" plehërash të çdo lloji.

Ditët e shpresës kanë filluar! "Planet janë të mëdha, por veprimet duhet të merren për të sjellë ujë të pastër në gojë e palara të djemve dhe vajzave Afrikane". Very Well Sir....! Deklarime "inkurajuese...! Zotëri i nderuar i superfuqisë më të madhe të botës mos harro se shumë vende e popuj janë të zhytur në skamje e mjerim! Ata nuk duan fjalë dhe as programe pompoze në letër, të cilat nuk i shërbejnë askujt. Kërkohen angazhime konkrete e dobiprurëse.

Kur në disa zona të planetit vdesin miliona fëmijë në vit a nuk është ky një trishtim e rrezik i madh edhe për vendet e pasura të botës së qytetëruar? Kontributi i ulët dhe i pamjaftueshëm i gjigandëve ekonomik të botës ndaj varfërisë ekstreme dhe mjerimit të qindra miliona njerëzve po ndikon negativisht në shtimin e shpejtësisë të "Anijes tonë Kozmike" duke rrezikuar daljen e saj nga "orbita".

Bota e pasur posedon mjete të fuqishme financiare e materiale për të ndihmuar deri në maksimumin e mundshëm vendët e varfëra dhe ata në zhvillim. Saharaja çdo ditë i afrohet Detit Mesdhe. Ekzistojnë të gjitha mundësitë që kjo shkretirë e pafund, e përafërt me sipërfaqen e Evropës, të bëhet një zonë me rendësi të madhe ekonomike. Një investim i jashtëzakonshëm në lumin Kongo, i dyti në Botë pas Amazonës, me një prurje vjetore disa herë më të madhe se e Nilit, do ndryshoj shtratin, pellgun dhe derdhjen e tij drejt Mesdheut duke e kthyer Saharanë dhe gjithë Afrikën veriore ndër vendet më të pasura e të populluara të Globit.

Mjerisht jemi larg këtij synimi. Ekzistojnë disa faktorë të rëndësishëm gjeopolitikë e social ekonomik të përmasave

planetare, të cilët e frenojnë këtë angazhim. Ato ndërthuren duke ndikuar fuqishëm në kohë, ngarkesë e kahe të ndryshme; kordinimi, harmonizimi dhe fokusimi i të cilëve do të ishte një burim i pashtershëm energjie dhe vlerash për zhvillimin e Afrikës, Lindjes së Mesme dhe mbarë Botës. Me vullnet të mirë dhe përqëndrim forcash nuk ka objektiv që nuk realizohet.

Katasrofën e afrojnë shpenzimet kolosale për armatimin, veçanërisht atë bërthamor. Në të gjithë botën ato arrijnë mbi njëmijë miliard dollarë në vit. Sot armët bërthamore të shkatërrimit në masë posedohen prej shumë shtetëve, disa të pa deklaruara, duke krijuar një mundësi permanente me rrezikshmëri shpërthyesë të lartë. Mjafton hedhja e një bombe atomike, pa folur për atë me hidrogjen, që bota të përfshihet në flakët e një zjarri të përbindshëm atomik.

Një rrezik tjetër real dhe misterioz, i cili "prodhon" armë ultra moderne tepër të sofistikuara me fuqi shkatërruese shumë herë më të madhe se ato që disponohen deri tani, ndodhet i "fshehur" dhe rritet çdo ditë në laboratorët atomik të shkencetarëve, fizikantëve dhe inxhinierëve të disa fuqive të mëdha të botës. Në këtë ndërmarrje ka pasion, vullnet dhe ambicie të shfrenuar për eksplorimin e të gjitha të fshehtave të mikrokozmosit. Studimet dhe eksperimentet shkencore për të zbuluar grimcat më të vogla elementare të atomit, që konsiderohen si gurët e fundit themeltarë të ndërtimit të natyrës, krahas dobive të mëdha për përparimin e Njerëzimit po krijojnë gradualisht një rrezik potencial të një apokalipsi planetar ku të mos mbetet kurrkush gjallë për të parë dhe përshkruar çfarë ndodhi mbrenda një të qindës të sekondës.

O Zot! Ruaje jetën mbi tokë. Në të gjithë Universin s'ka vend më të mirë se kjo botë.

Burime të pashtershme energjie ndodhën në Tokë. Përdorimi intensiv, së pari i energjisë diellore, është me interes e leverdi të madhe. Një rëndësi të veçantë mer edhe shfrytëzimi rigoroz, sipas kritereve tekniko-shkencore, i burimeve hidrike. Është llogaritur që vetëm në ngushticën e Gjilbraltarit, e cila "lidhë" si një urë gjigande Oqeanin Atlantik me Detit Mesdhe, mund të ndërtohen disa hidrocentrale të përmasave të papara, të cilat do furnizojnë me dritë e energji gjithë Evropën dhe Afrikën sëbashku.

Natyrë kurdoherë është e bukur, jetëdhënëse, bujare dhe në përgjithësi sillet mirë me ne. Veprimtaria e përditshme si edhe aksionet individuale e masive për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit janë tregues cilësor të qytetërimit tonë. Por kur ne, njerëzit, nuk e përfillim dhe e demtojmë, ajo hap pas hapi ndryshon duke u bërë më e egër, tekanjoze e hakmarrëse. Çdo gjë varët në dorën tonë. Ne kemi mundësi ta parandalojmë Apokalipsin.

SI NDIKON GËZIMI, LUMTURIA E QESHURA DHE USHQYERJA MBI SHËNDETTIN?!

Sipas një studimi Australian në 10 mijë veta tregohet, se ato që janë shumë të lumtur, të gëzuar, të kënaqur janë mirë me shëndet deri në 3-vjet më vonë .

E qeshura është një paravendosje ose kundra-vënie për sëmundjet e zemrës, nën efektin e saj krahas ndikimit psikologjik pozitiv, qeshja shërben si gjimnastikë për diafragmën dhe ka një seri tkurrjesh dhe relaksimesh që vepron mbi mushkëritë, masazhon stomakun dhe zorrët, oksigjenon organizmin duke aktivizuar qarkullimin e gjakut.

Kërkuesit e Universitetit Baltimore USA kanë konfirmuar se e qeshura vepron po aq mirë mbi sistemin e qarkullimit të gjakut dhe zemrën sikurse të merresh me sport , pasuron me gjak zemrën tonë ,bën që të ulët rreziku i trombozës dhe infarktut . Një dozë lumturie e përditshme , për 10 min mjafton për të ulur presionin e gjakut , 120 min lumturi ishte baras me një kurs aerobie ose me një seancë kërcimi . E qeshura bën që të shpërthejë një reaksion i kaskadës hormoneve veçanërisht e endorfinave (hormoneve të lumturisë) Një minutë lumturi sjell të njëjtin përfitim sa 45min relaksim . Endorfinat janë analgjezik (ulin dhimbjen) natyral dhe paralelisht ulin dhe nivelin e adrenalines dhe kortizonit . Dihet se kortizoni ul dhe prodhimin e antikorpeve mbrojtës kështu që e qeshura rrit imunitetin tonë .

Gëzimi ,lumturia e qeshura duke ulur stresin ul prodhimin e lëndëve simpatikomimetike (adrenaline,noradrenaline,) po ashtu ul aciditetin e stomakut , stimulon prodhimin e lëngut pankreatik duke favorizon tretjen .

Jeta në çift ose bashkëjetesa garanton jetë-gjatësi. Në British Medical Journal thekson se ato që jetojnë në çift kanë një nivel vdekshmërie nga 10-15% më të ulët se popullata tjetër . Por kini kujdes vetëm bashkëjetesa e lumtur përmirëson shëndetin e grave , kërkuesit amerikan kanë studiuar 493 gra për 13-vjet te martuara ose në bashkëjetesë ,ato që ndiheshin mirë në bashkëjetesë kishin tension arterial te ulte, nivel kolesteroli me te ulte dhe me pak kile mbi peshe . Për burrat një studim japonez në mbi 100.000 persona te moshës nga 40-80 vjeç treguan se jeta si beqar nuk kishte vlerë , gjysma e tyre rrezikonin të vdesin nga sëmundje kardio-vaskulare 3-herë me tepër se sa të martuarit , nga sëmundjet e mushkërive 2.5 herë dhe nga grupet e tjera të sëmundjeve koeficienti ishte 2 herë më tepër.

Po e njëjta tendencë ishte dhe për gratë por në një proporcion me te vogël . Vlen te theksohet se marrëdhënia në çift ndikon shumë , kërkuesit e Brygham Jong Univesity kanë treguar se një martesë e keqe është me e keqe sesa beqaria.

Dashuria , lumturia e seksit rrit me 10-vjet jetëgjatësi . Shkencëtarët kanë kuotizuar seksin ,se për te qene në forme duhen te paktën 3 orgazma në javë ,gjë që do te ulte 50% rrezikun për te pasur kriza zemre ose atak cerebro-vaskular ,ishemi ose stroka –hemorragji cerebrale.

Te përjetosh qiellin e 7-te ku arrin në

zenit imunoglobulinat tona IgA që rrisin mbrojtjen e organizmit për te luftuar kundër infeksionit . Nëse burrat kanë një orgazëm në javë ulët me 1/3 rreziku i kancerit te prostatës ose 33% . Për gratë kemi mbrojtje nga kanceri i gjirit , dhe çlirimi i dopaminës , adrenalines, testosteronit (dhe tek grat që bëjnë dashuri ruhet kapitali rinor i tyre) Lodrat ,kërcimi stimulon prodhimin e estrogeneve rritet një antidot i shkëlqyeshëm për dhimbjet paramenstruale dhe ulen afshet e nxehta .

zgjidhje.

Nuk është fjala për të dhëne optimizëm në prehje lumturie por në përqendrimin në anën e mirë te gjerave altruizmi (shpirtmirësia) miqësia ja ku bazohet kjo shkencë e lumturisë ,dhe kjo është provuar në mënyre shkencore . Lumturia nuk është shans (fat) nuk është e paracaktuar , por është kthimi i shprese duke i pare gjerat me syrin e mendjes . Një studim i realizuar në 4 mijë binjak konfirmoj një ndryshim ‘ekstrem’ (te

ulur krizat kardiace dhe atakët vaskulare cerebrale .Njëkohësisht përdorimi I pijeve te gazueshme është shumë I dëmshëm ,prandaj kthehuni te çaji dhe uji mineral natyral . Sipas te dhënave 180 mijë vete vdesin çdo vit nga një sëmundje e lidhur me konsumimin e pijeve te gëzueshme në bote . Ku afër 45 mijë prej tyre janë te shkaktuara nga krizat e zemrës. Pra këto persona kanë tendence te shtojnë peshe ,te vuajnë nga sëmundja e sheqeri dhe te pësojnë bllokim te enëve



Miqësia është antidote e stresit.

Shoqëria, marrëdhëniet shoqërore te mira ,bashkëpunimi përforcon shëndetin mendore dhe fizik .Sipas Universitetit te Los Angeles UCLA Californi miqësia e mirë midis grave do te ketë efekt te mirë mbi stresin dhe efekte anësore. Kur ne jemi te stresuar truri jonë çliron sasi lëndesh kimike midis te cilave është specifike tek femrat oxtocina që stimulon dashurin ,ndjeshmëri ,nxit lindjen dhe ardhjen e qumështit te gjirit , pengon refleksin e agresivitetit dhe mbylljes në vetvete (vetmisë) i ndihmon që te merret nën kujdes fëmija dhe në ketë mënyre oxtosina ndihmon në administrimin e mirë te stresit . Një tjetër studim amerikan tregon sesa me shume miq të kemi aq me pak do te jemi te prekur nga handicapë (defekte fizike në pleqëri) dhe kemi më shume shans për një jete me te gëzuar dhe mungesa e miqve është e dëmshme për shëndetin po aq sa dhe pirja e duhanit .

-Te mësohesh që të jesh i lumtur

Psikologjia pozitive e studiuar dhe e mësuar prej një dizin vitesh ka sjellë

pamjes) ,te qenurit mire apo keq ,te pasur apo te varfër ,te ri apo lodhur pavarësisht moshës kjo përben vetëm 10% te kapitalit tone te lumturisë ajo që lëviz në kokën tone është 40% mbetja nuk duket se është trashëgimi gjenetike . Dhe mënyra e ushqyerjes ndikon në lumturi ,nga te qenurit mire ; se pari pjata e juaj duhet te jete plot me ngjyra me lloj-lloj asortimentit ,pra duhet te kthehemi tek produktet e freskëta me perime bio . Si karrota ,spinak ,laker ,selino ,brokuli,panxhari etj.

Kjo parandalon bllokimin e enëve te gjakut në zemër dhe tru . Këtu ndodhet shumë vitaminë, minerale ,fiba ,fito nutrient që te gjitha te mira për shëndetin e zemrës tone .Sidomos vitaminat e grupit B si vit. B6 e cila kontribuon në uljen e homocisteines (aminoacid I lidhur me sëmundjet e zemrës)dhe te protienes C-reaktive që është marker (shënues) i inflamacionit .Po ashtu dhe frutat mandarin ,limon portokall të cilat janë te pasura me karoteinoind, lekopen antioksidant te rëndësishëm . Këshillohen te paktën 5-8 porcione perime dhe fruta në ditë për te

te gjakut si rrjedhojë e nivelit te lart te sheqerit dhe e çrregullimit të proteinave dhe rritjes se yndyrave te rrezikshme si kolesterol ,triglyceride dhe homocysteine .Shkencëtarët e Havardit kanë studiuar mbi 40 mijë mjeke dhe 88mije infermier për mbi 2 dekada ku u vërtetua se grat që konsumojnë mbi 2 porcione pije te ëmbla te gazuar në dite vuajnë mbi 40.5 % te raste nga sëmundje zemre krahasuar me ato që përdorin pak ose fare këto pije . Në anën e burrave vuajtja ishte 20% . Si përfundim ushqyerja e rregullt duke respektuar gustot dhe pamjen e shije e pjatave duke shmangur pijet e gazuara dhe të ëmbla përmirësohet humori ,lumturia gjë që çon në mungesën e sëmundjes . Prandaj këshilla është shtoni çdo ditë nga një porcion fruta dhe perime dhe mos merrni më pak se 5 porcione në dite, idealja do të ishte të merrni 8 racione në ditë.

Përgatiti: Med. Ndue Nikaj

ROLI I FËMIJËRISË SË HERSHME PËR JETËN E NJERIUT

Psikologët, vazhdimisht e vrasin mendjen, mbi arsyet e dhunës tek njeriu, përse njeriu është i dhunshëm?

Disa e shpjegojnë si trashëgimi gjenetike, të tjerë si produkt i hormonit testosteron. Të dy këta faktorë e nxisin njeriun drejtë dhunës, krimin.

Grupi tjetër, mendojnë se, vendimtare për natyrën e njeriut të ardhshëm, është mjedisi ku ai rritet. Ashtu si janë sjellur të tjerët me atë, gjatë fëmijërisë së hershme, do të silltet ai në jetë, me veten e vet dhe me të tjerët. Kjo do të thotë se, dhuna mësohet dhe nuk trashëgohet.

Disa të tjerë mendojnë se, asnjëri nga këta faktorë, veç e veç, nuk mund të mendohet si burimi i plotë i dhunës tek njeriu. E sigurtë është se, edukata në fëmijërinë e hershme, luan një rol vendimtar në zhvillimin e personalitetit të njeriut. Ai që, në moshën e fëmijërisë ka përjetuar dhunë, do ta ndjejë atë gjithë jetën e vet. Nuk do të mund të çlirohet kurrë nga ndjenja e poshtrimit. Dhe munëdsia që, ai të bëhet i dhunshëm, është shumë e madhe. Edhe nëse ka parë dhunë në familje, kur dikush ka dhunuar dikë tjetër. Një gjë është shumë e sigurt: Mekanizmi i ndjenjave është goditur. Shkalla e demtimit, do të duket më vonë.

Kam pasur shumë raste bisedash me kriminelë dhe, pjesa më e madhe e tyre, kishin përjetuar dhunë në familje, në fëmijërinë e hershme. Janë ndëshkuar ashpër, rrahur, ose kanë parë, si janë dhunuar të tjerët, në prezencën e tyre.

Në raste të tilla, psikologët mendojnë

se nuk është fjala thjeshtë për një dobësim të vetëbesimit por, për humbje të vetëkontrollit mbi ndjenjat, në mardhënje me të tjerët.

Pa snjë diskutim, prindët që përdorin dhunë në familje, mbi fëmijët apo mbi njeri-tjetrin në prezencën e fëmijëve, janë fajtor dhe mbajnë një përgjegjësi të madhe për të arthmen e dhunshme të fëmijëve të tyre, pavarësisht nga shkaqet dhe rrethanat.

Shumë njerëz, kujtojnë me nostalgji fëmijërinë e tyre të hershme, si një parajsë dhe, sa më shumë që i largohen asaj, aq më shumë ia ndjejnë nevojën. Por, mjerisht, ka dhe shumë të tjerë, ndoshta janë shumica, të cilët, kur e kujtojnë fëmijërinë e tyre, traumatizohen. Pavarësisht sa shumë janë larguar nga ajo. Ata kujtojnë trajtimet e padrejta, presionin për të qënë perfekt dhe, ndëshkimet e ashpëra për gabimet që bënin. Kujtojnë kërkesat e mëdha që duhej t'u përgjigjeshin egoizmit të prindëve të tyre, frikën e ndarjes së prindve, frikën e dhunës në familje nga alkoholi. Kujtojnë mbylljet e tyre në dhoma të veçanta si ndëshkime disiplinore për gabimet e tyre, dhunën seksuale. Kujtojnë frikën e braktisjes, të harresës, të humbjes së njërit apo tjetrit prind. Shumë nga ata janë të vetëdijshëm se, një fëmijëri e tillë e hershme, ka ndërtuar hendekun e madh të komunikimit, midis atyre dhe shoqërisë ku jetojnë.

Kati i parë i jetës, fëmijëria e hershme, përcakton gjithë godinën e jetës të njeriut. Askush nga ne nuk është aq i madh sa

duket. Të gjithë jemi "fëmi", nën lëkurën e vjetër. Në lëkurën tonë, jeton "fëmia" ynë, jemi ne, në moshën fëmimore.

Sot, në moshën e pjekur, ne na kujtohen shumë gjëra nga koha e fëmijërisë të cilat nuk i kemi dashur por, megjithë mbrojtjen tonë, jemi detyruar t'i pranojmë ose bëjmë. Edhe sot, kur i kujton ato, sillesh në të njëjtën mënyrë. Me të drejtë pyet: Kush jam unë që nuk i pranoj ato gjëra që nuk i kam pranuar as atherë, unë i sotmi apo "fëmia" im i athershëm, brënda meje?

Shumë të rritur të cilët, në kohën e fëmijërisë janë mësuar me frikën nga qeni, gjithë jetën e tyre vuajnë nga kjo ndjenjë frike. Kush ka frikë nga qeni, ti apo "fëmia" yt, brënda teje?

Sigurisht që keni njohur njerëz të cilët kanë frikë nga errësira. Madje dhe burra muskulozë të cilët, nga pamja e jashtme, të duken sikur nuk kanë frikë nga asgjë. Dhe të lindë pyetja: Kush ka frikë nga errësira, ky muskuloz apo "fëmia" brënda tij?

Eva është dyzet vjeçe. Ajo ka frikë nëse burri i saj ia fërkon fytyrën me duar, megjithëse ajo e di se ai e bën këtë në shenjë përkrahjeje. Kjo i kujton asaj shuplakat që ka ngrënë në fytyrë nga babai, pijanec, kur ka qënë e vogël.

Ne të gjithë jetojmë tani por, ndjenjat i kemi të fëmijërisë dhe reagojmë si atherë. Shpesh, në jetën tonë private dhe në mardhënje me të tjerët, ne sillemi si fëmi. Na pëlqen ta qortojmë veten dhe të tjerët, ashtu siç na qortonin ne prindët tonë, kur ishim të vegjël.

Nëse nuk do ta ndajmë veten nga "fëmia" ynë, brënda nesh, do të mund të orientohejmë shumë më mirë në jetë. Nëse nuk do t'i ndajmë njerëzit e dhunshëm nga fëmijëria e tyre, do të mund t'i kuptojmë dhe ndihmojmë shumë më mirë ata.

Ne plakemi vetëm nga jashtë ndërsa nga brënda, mbetemi "fëmia" ynë, reagojmë si atherë.

Nga kjo dalin dy konkluzione të qarta:

1. Ne sillemi në jetë, ashtu siç janë sjellur me ne, ata që na kanë edukuar.

2. Ne mbartim brënda nesh, atmosferën e familjes ku jemi rritur.

- Nëse ke përjetuar presion nga prindët, do të vazhdosh ta ushtrosh atë mbi veten tënde dhe të tjerët.

- Nëse prindët dhe edukatorët kanë qënë të pakënaqur me ty dhe, të kanë qortuar vazhdimisht, edhe ti do të vazhdosh të jesh i pakënaqur me veten tënde dhe të tjerët.

- Nëse të kanë izoluar nga të tjerët kur ke qënë fëmi, edhe tani e ndjenë nevojën e vetmisë, nuk të pëlqen jeta në kolektiv. Je një kooperues shumë i vështirë.

- Nëse prindët të kanë thënë, ti je i paaftë, i pazoti, gjithmonë do të vuash nga ndjenja e pazotsisë, pavarësisht nga arritjet e tua.

- Nëse ke përjetuar skena dhune apo je dhunuar nga të tjerët, nuk do të mund të çlirohesh kurrë nga frika e dhunës dhe dëshira për hakmarrje.

"Fëmia" brënda teje nuk njeh as të kaluar dhe as të arthme. Ai njeh vetëm kohën e vet, atë që ka jetuar vetë dhe ato që ka përjetuar vetë.

Në rastet kur kemi të bëjmë me familje të dështuara, a mund të ndërhyjë shoqëria? Nëse po, si dhe kur?

E vërteta është se, njeriu i vështirë, nuk është problem vetëm për veten e vet dhe familjen që i takon. Ai është po aq një problem social. Kjo do të thotë se shoqëria, të gjitha rastet e njerëzve të dështuar, duhet t'i shikojë dhe vlersojë si probleme të vetat, brënda vetes dhe jo jashtë vetes. Është i njohur fakti që, fëmijët e demtuar psikikisht apo në mekanizmin e ndjenjave, nëse ftohen në një mjedis social paqësor, mund të rehabilitohen plotësisht. Por, një gjë e tillë duhet bërë shpejt dhe nga njerëz të specializuar.

Lekë Imeraj

shkrimtar dhe përkthyes

SHKOLLA 9-VJEÇARE "DEDE GJON LULI" PËR PËRSHËRËSË NË LOJËRAT POPULLORE "FESTË - 12"

Grupi artistik i shkollës 9-vjeçare "Dede Gjon Luli" Hot i Ri mori pjesë në lojërat popullore "Fest - 12", i organizuar nga Bashkia Shkodër, me organizatën THT-DOOR, në Njësinë Administrative Ana e Malit, me datën 20. 04. 2019.

Shkolla jonë konkurroi me dy numra artistik:

1. Vallja e "Mrizit", me motive folklorike. Interpretoi grupi i valles.

2. Vallja humoristike e shatit. Interpretoi Pamela Mirashi, Mirsad Biga dhe grupi i valles.

Me këtë prezantim të mirë, trupa folklorike e shkollës sonë u vlerësua me çmimin e II-të,

Një falënderim i veçantë është për atë, që i përgatiti pa pushim, mësuesen Drita Zefi.

Kjo është një nxitje për veprimtari të tjera për ne, si shkollë.

Me duartrokitje të forta u prit dhe surpriza e piktorit të shkollës sonë, nxënësit të klasës VIII, Emanuel Lungaja i cili në emër të shkollës sonë, i kishte përgatitur një portret z. Kastriot Faci, i cili tha se është surpriza më e bukur për mua.

Gjovalin Kodra



Kastriot Faci, është Presidenti i organizatës THE-DOOR, me qendër në Shkodër, që organizon lojërat popullore për të 12-vit rresht.



T'I MBROJME SPECIET TONA - DITA E TOKËS 2019

“Në natyrë, asgjë nuk ekziston vetëm.”- Rachel Carson, 1962

Pergatiti, Ing. Gjon Fierza*


Dhurata e natyrës në planetin tonë janë miliona specie që njohim dhe i duam, dhe shumë më tepër që mbeten për t'u zbuluar. Për fat të keq, qeniet njerëzore kanë çrregulluar në mënyrë të pakthyeshme bilancin e natyrës. Bota po përballet me shkallën më të madhe të zhdukjes së shpejtë të specieve; kjo është rezultat i aktivitetit njerëzor. Reduktimi i shpejtë i popullsisë së bimëve dhe kafshëve të egra janë të lidhura drejtpërdrejt me shkaqet e nxitura nga aktiviteti njerëzor: ndryshimi i klimës, shpyllëzimi, humbja e habitateve, trafikimi dhe gjuetia, bujqësia e paqëndrueshme, ndotja dhe pesticidet për të përmendur disa.

Nëse nuk veprojmë tani, zhdukja mund të jetë trashëgimia më e qëndrueshme e njerëzimit. Të gjitha gjallesat kanë një vlerë të brendshme dhe secili luan një rol unik në zinxhirin e ndërlikuar të jetës. Ne duhet të punojmë së bashku për të mbrojtur speciet e rrezikuara dhe të kërcënuara të florës dhe faunes me vendjetesat e tyre. Lajm i mirë është se shkalla e zhdukjeve ende mund të ngadalësohet dhe shumë nga speciet tona në rënie, të kërcënuara dhe të rrezikuara mund të rimëkëmben, nëse punojmë së bashku tani për të ndërtuar një lëvizje globale të bashkuar të konsumatorëve, votuesve, edukatorëve, udhëheqësve të besimit dhe shkencëtarëve për të kërkuar veprim të menjëhershëm. Në Ditën e Tokës 2019 u kërkohet njerëzve të bashkohen me fushatën “Për mbrojtjen e specieve tona”. Ku synohet: Edukimi dhe rritja e vetëdijes për shkallën e përshpejtimit të zhdukjes së miliona specieve dhe shkaqeve dhe pasojave të këtij fenomeni.

Arritja e fitoreve kryesore të politikave që mbrojnë grupet e gjera të llojeve, si dhe speciet individuale dhe habitatet e tyre. Ndërtimi dhe aktivizimi një lëvizje globale që përfshin natyrën dhe vlerat e saj. Çfarë duhet të dini për drurët dhe pse duhet t'i mbrojmë ato si speciet me të rëndësishme të botes organike!?

Fakte rreth drureve (pemëve). Ka rreth 60,000 lloje të ndryshme të drureve dhe shkurre pyjore dhe drure frutore e zbukurues. Bimësia më e vjetër drunore që ka jetuar në tokë, datojnë afro 350 milionë vjet, dhe pema më e vjetër e regjistruar në botë - ëshë 9,500 vjeçare e zbuluar në Suedi. Pemët janë të shumëllojshme dhe aq të ndryshme si nga: frutat që rriten, ngjyrat e gjetheve të tyre, forma dhe lartësia e tyre. Nga viti 2015 në vitin 2016, bota humbi 73.4 milionë hektarë pyje, një rritje 51% nga një vit më parë. Aktiviteti njerëzor vazhdon të jetë shkaku i vetëm më i madh i shpyllëzimit. Pse kemi nevojë për të mbrojtur druret (pemët) Roli në ekosistem: Pemët luajnë një rol qendror në ekosistemet e pyjeve dhe specieve të tjera. Pyjet luajnë një rol jetësor në ruajtjen dhe shkarkimin e karbonit nga at-

mosfera dhe ndihmojnë në rregullimin dhe ruajtjen e ekuilibrit të karbonit të Tokës. Pemët gjithashtu ndihmojnë në ruajtjen e tokës së pasur me lëndë ushqyese për rritjen e bimëve të tjera, sigurimin e strehimit dhe habitatit për kafshët dhe kontribuojnë dukshëm në ciklin e ujit



global. Shërbimet e ekosistemit: Një nga shërbimet më të rëndësishme që sigurojnë pemët është sekuestrimi i karbonit, i cili ndihmon në ruajtjen e ajrit të pastër dhe temperaturat e afërta në një nivel të shëndetshëm. Përveç kësaj, pemët kanë një rol të fuqishëm në sigurimin e mirëqenies në mjedise urbane dhe rurale.

Kontributet ekonomike: Globalisht, vlera e drurit të lëndës djegëse dhe produkteve me bazë drusore vlerësohet të jetë 400 miliardë dollarë.

Kërcënimet ndaj drureve (pemëve) Shpyllëzimi: Largimi i pemëve për qëllime komerciale, bujqësore dhe rezidenciale ndodh në mbarë botën. Disa shkencëtarë që vlerësojnë se të gjitha pyjet e shiut në botë mund të humbasin në shekullin e ardhshëm.

Ndryshimi i klimës: Nivelet në rritje të dioksidit të karbonit të bllokuar në atmosferën e Tokës kërcënojnë aftësinë e pemëve për të kthyer karbonin në oksigjen, duke dobësuar kështu shëndetin e tyre. Rritja e temperaturave nga ndryshimet klimatike gjithashtu mund të dëmtojë ciklin e brendshëm të jetës së një peme, duke përfshirë aftësinë për të riprodhuar.

Insekte: Një nga kërcënimet më të përhapura ndaj pemëve në mbarë botën është prevalenca e specieve jo-amtare të insekteve që mund të shkaktojnë dëme të pariparueshme për pemët. Në SHBA, 63% e pylltarisë kombëtare të vendit kërcënohet nga insektet invazive.

Zjarret në pyje: Mungesa e rreshjet dhe temperaturat e rritura po shkaktojnë mjedisë më të ngrohta dhe më të thata, duke i bërë pyjet shumë më të prirur nga zjarri. Zjarret në pyje gjithashtu po bëhen më intensive dhe vdekjeprurëse, duke liruar më shumë karboni në atmosferë dhe duke reduktuar në masë të madhe aftësinë e ekosistemit për t'u rimëkëmbur. Çfarë mund të bëni për të mbrojtur pemët .

Mbjellje e sa me shume fidanave, pyjor, frutor dhe zbukurues. Nisur në vitin 2016 deri në Dita e Tokës 2020, Fushata nderkombetare “Drurë (Pemë) për Tokën” synon të mbjellë 7-8 miliardë pemë në vit – një dru për çdo person në Tokë. Avokati për pemët urbane: Ndërsa bota bëhet më e urbanizuar, do të jetë e rëndësishme të ruhet pemët urbane në qendra të dendura të popullsisë. Kërkesat dhe inkurajimi i qeverisjeve vendore që të miratojnë plane dhe marrin masat e mbjelljes së pemëve me një pjesëmarrje të banorëve vendor. Vetëm kështu arrihen përfitime shëndetësore dhe ekonomike për të gjithë komunitetin. Të mbështesin ndalimin e përdorimit të pesticideve, sidomos insekticidëve neonicotinoid. Mbjellja dhe rritja e bimëve vendase është një mënyrë e rëndësishme dhe me kosto efektive për të ndihmuar në shpëtimin e bimëve. Bimët vendase përshatën më mirë me kushtet e mjedisit lokal, ato kërkojnë më pak ujë dhe gjithashtu përmirësojnë cilësinë e ajrit. Blerje e produkteve të qëndrueshme të bimëve: Të jesh një konsumator i informuar dhe të njohësh bimët dhe produktet e bimëve është një hap i parë i rëndësishëm.

Dita e Tokës dhe në Dukagjin.

Alpet shqiptare, ku shtrihet dhe krahina e Dukagjinit përbëjnë peizazhin më me vlera unike të Shqipërisë, ku rriten dhe zhvillohen mbi 1600 lloje bimësh. Flora e territorit të Alpeve perben 48 % të flores se vendit tonë. Janë një numër i konsiderueshëm bimësh endemike dhe subendemike, të cilat zhvillohen në Alpe ato zene 40% të bimëve endemike që rriten në Shqipëri. Për fatkeq disa rrezikojnë zh-



dukjen, siç janë Vulfenja Baldaçi apo Manushaja e Dukagjinit, grosha e Shalës, disa lloje misri (kallamoqi), etj. Në Alpet tona rriten shume kafshë e shpende të egra siç janë: ariu, ujku, dhia e egër, kaprolli, shqiponja e malit, etj.

Tashme kur Lugina e Shalës me kryefjalë Thethin në fillim dhe Blinin e Gurit të Lekës në fund, është kthyer në një shtegtim të rëndësishëm turistik ku numri i turistëve vendas dhe të huaj rritet ndjeshëm nga vit në vit, flora dhe fauna janë më të kërcënuara dhe nën një presion më të madh. Informimi dhe ndërgjegjësimi i banorëve vendor së pari dhe të gjithë atyre që vizitojnë këtë zonë duhet të jetë i madh për të mos lejuar jo vetëm

zhdukjen e llojeve por dhe përkeqësim të gjendjes tyre. Për nga vlerat flori dhe faunistike duhet përmendur dhe lugina e Kirit, ku ka rriten dhe zhvillohen shumë bimë dhe kafshë të egra. Në këtë luginë ka vendbanime dhe jeton riqebulli, një kafshë me një status të vecantë mbrojtje në Europë. Lugina e Kirit për fatkeq është pak e studjuar dhe akoma me pak njihen vlerat e saj. Dita e Tokës, është një ditë që së shumti të mund të promovohet për të mbrojtur bimët, kafshët dhe mjedisin në tërësi. Dikur 22 prilli konsiderohej si dita e kur dimri kishte ikur përfundimisht në malësitë tona, kur kishte dalë gjethi e bari, pra ishte festa e Shëngjergjit të parë. Pra ka pasur një traditë feste të kesaj date në Dukagjin, tashme ndoshta duhet marrë përmasa dhe vizion të ri më të shtuar. Pasuritë floristike dhe fanuistike të Dukagjinit kërkojnë mbrojtje gjithnjë dhe nga të gjithë.

Historia e Ditës së Tokës

Çdo vit, Dita e Tokës - 22 prill, shënon përvjetorin e lindjes së lëvizjes moderne mjedisore në vitin 1970. Ideja për një ditë kombëtare për t'u përqëndruar në mjedis erdhi tek themeluesi i Ditës së Tokës, Gaylord Nelson senator amerikan nga Wisconsin. Më 22 prill 1970, 20 milionë amerikanë dolën në rrugë, në parqe dhe në auditorë për të demonstruar për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm në bombardimet masive në bregdet. Mijëra kolegje dhe universitete organizuan protesta kundër përkeqësimit të mjedisit. Dita e Tokës në vitin 1970 arriti një shtrirje të rrallë politike, duke siguruar mbështetje nga republikanët dhe demokratët, të pasur dhe të varfër, shakarë të qytetit dhe fermerë, manjatë dhe udhëheqës të punës. Deri në fund të atij viti, Dita e parë e Tokës kishte çuar në krijimin e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Mbrojtjen e Mjedisit dhe kalimin e Aktit të Ajrit Pastër, të Ujit të Pastër dhe Specieve të Rrezikuara

Ne vitin 1990, Dita e Tokës mori përmasa globale, duke mobilizuar 200 milionë njerëz në 141 vende dhe duke bere publike çështjet mjedisore në skenën botërore. Dita e Tokës 1990 i dha një shtysë të madhe përpjekjeve të riciklimit në mbarë botën dhe ndihmoi në hapjen e rrugës për Samitin e Tokës të Kombeve të Bashkuara në Rio de Janeiro. Ajo gjithashtu nxiti Presidentin Bill Clinton të nderonte senatorin Nelson me Medaljen Presidenciale të Lirisë (1995) - nderimi më i lartë i dhënë civilëve në Shtetet e Bashkuara - për rolin e tij si themelues i Ditës së Tokës. Dita e Tokës tashmë ka arritur në statusin e saj aktual si një ditë me të shenuara, më e madhe laike në botë, e festuar nga më shumë se një miliard njerëz çdo vit dhe një ditë veprimi që ndryshon sjelljen njerëzore dhe shkakton ndryshime në politikë. Sot, lufta për një mjedis të pastër vazhdon me rritjen e urgjencës, pasi shkatërrimet e ndryshimeve klimatike bëhen më të dukshme çdo ditë. Ne të gjithë duhet të jeni pjesë e Ditës së Tokës dhe për të shkruar shumë kapituj të tjerë, betejat dhe fitoret në librin e Ditës së Tokës-2020 shënon 50 vjetorin e Ditës së Tokës .

*Agjencia Kombetare e Mjedisit, Tirane

PROFESORI I MATEMATIKËS DHE VAJZA SHQIPTARE

(Tregim i jetuar)

Një burrë i gjate, i pashëm, me një shikim endë të kthjelltë edhe se i kishte kaluar 93 vitet e jetës tij, qëndronte i shtrirë në dhomën nr. 5 të spitalit "San Antonio Abate", në Gallarate Itali, në të cilin isha i shtruar edhe unë.

Me respekt të veçantë, të gjithë e thërrisnin profesor. Fliste ngadalë e me një frymëmarrje, e cila shkonte e vinte, sa ndonjëherë mendoja se do t'i shkonte e nuk do ti kthehej kurrë më. Vajza, e cila i rrinte te koka duke e preokupuar dhe here pas here i fërkonte duart, i rregullonte rrobat dhe ashtu shtrirë i jepte për të ngrënë me një lugë të vogël, duke i pastruar çdo grimcë apo njollë në buzë e rroba. E gjatë, e pashme e me një fytyrë engjëjlore, ajo i bënte lëvizjet gati pa rënë në sy. Dy ditët e para mendova, se ishte e bija e profesorit, por më vonë zbulova, në një bisedë telefonike, e cila po fliste në gjuhën time, shqip! Prita sa mbaroi bisedën dhe i fola. Ajo i u afrua shtratit tim, që e kisha përballë dhe biseduam në shqip sikur të ishim të njohur të vjetër.

Si zakonisht, në këto raste njeriu mundohet të prezantohet sa më real si shqiptar, por edhe si emigrant, që tashmë ishim të dy të një krah, si të huaj në vendin e huaj. Ndërkohë pashë se u hap dera dhe brenda hynë dy djem dhe një nuse e re dhe zunë vend rreth krevatit të profesorit.

Vajza shqiptare ma bëri me shenjë në drejtim të të ardhurve dhe në shqip më tha, se janë të vetët, janë nipat e profesorit dhe kur po bëhej gati të dilte lëshoi gati si psherëtime "e çmenden".

Dy nipat dhe nusja e njërit prej tyre e rrethuan shtratin dhe lëshuan një mori lëvdatash, me disa të qeshura të shtira sa dukeshin si copa maskash në një dite karnavalesh. Pastaj filluan të flasin për diçka krejt tjetër sa unë me zor arrita të kap këtë bisede: "Ja dokumentet i kemi gati, të lutem vene firmën. Nonno a dëg-

jon, vene firmën dhe çdo gjë do të shkojë mire!"

Të tre flisnin here me ton e herë e ulnin zërin duke krijuar një ambient sikur ishte në një tip hetuesie. Plaku vetëm shikonte dhe kur e mërzhiten me lutje për atë drejt firmë, ai vetëm luajti kokën në shenjë mohimi. U ngritën e dolën në korridor, pastaj u kthyen një nga një!

Dëgjova, se nusja i tha: "Kemi blere divane të rinj, kam vendose lule në dhomën e madhe dhe do të habitësh kur të vish!" Pastaj me ton gati nen zë i kërkoi përsëri firmën. Ai as nuk i hodhi sytë kësaj radhe. Të njëjtën gjë bën edhe djemtë. Ikën duke i thanë, që të mendohet mire, se do të ime nesër, përsëri. Dolën duke tërhequr derën, që dha një krizëm gati nervoze.

Plaku u mundua të tërheqë me tërë fuqinë që i kishte mbete rrobat, të cilat gati po i binin për toke, me mendimin që të kalonte disa orë në qetësinë e vet. Por nuk ishte e thënë. Mu bë sikur që vetëm një ndërrim turnesh. Në derë u duk një çift më i vjetër dhe dallova, se burri i thirri baba. Ai hapi çantën. Përsëri një letër, përsëri i kërkonte të firmoste. Kësaj radhe tonet ishin më të vrazhda dhe disi kërcënues. Në një të moment gruaja i mori dorën dhe i vuri një stilolaps e duke i shtrirë letrën i tha ja këtu, këtu.

Nuk di ku gjeti atë forcë dhe plaku e tërhoqi me shpejtësi duke kthyer kokën nga ana tjetër. Ikën plot inat për tu kthyer përsëri nesër, e përsëri me letër në dore. Pastaj erdhi edhe prifti. I kërkoi që të rrëfehej e të merrte kungimin.

Në fund i beri një kërkesë në formë diplomatike: "Në qoftë se keni ndërmend të leni ndonjë testament, e para është shtëpia e Zotit!" Pastaj ngriti dorën dhe duke bere shenjen e kryqit doli.

Profesori i kishte ngulur sytë dhe nuk foli asnjë fjalë. Mu duk sikur lundronte midis dy boteve dhe nervozizmi e irritimi që i kishin shkaktuar vizitoret, i kishte lënë një shije të hidhur, gjë që shprehej në sytë e ngarkuar gati për të derdhur stuhi

shiu.

Vajza shqiptare me emrin Alma hyri dhe u ul pranë plakut. Ai i mori dorën dhe krejt i përbotur filloi t'ia puth. Alma më shikoi mua e u duk se po i vinte zor nga prezenca ime. Të lutem Alma, mendo se asht babai yt e jepi gjithë dashurinë shpirtërore e njerëzore - i fola në shqip. Ajo u lëshua mbi te dhe qanin te dy. Pikat e lotit, që i buronin nga ato sy të mëdhenj e të bukur i binin mbi çarçafët e bardhë. E përqafoi, i puthi ballin, faqe e duar e ashtu në qetësi u krijua një ambient tepër prekës. Edhe mua më kishte mbetur fjala në grykë e veç shikoja atë skenë, që nuk do të më shqitet kurrë.

Në darke, kur plaku u vendos disi në qetësi, Alma u ul në anë të krevatit tim dhe me një shqipe të pastër të zonës së Beratit, më tregoi historinë e dhimbshme të profesorit; me një grua të vdekur kohe më parë, me dy djem, të cilët me vite ishin larguar dhe nuk donin t'ia dinin për babain e vetmuar, të lënë në mëshirën e fatit, në një qytet periferik të Lombardisë, me nipa që u kishte dhanë gjithë atë që mund të japë një gjysh për gjakun e gjakut, por ishin rritur e tashmë shikonin vetëm jetën e tyre.

Deri te nëntëdhjetat plaku kuronte vetveten me të larë, për të ngrënë, për pastrime e të tjera, pastaj kishte thirrur emigranten Alma. - Jam tre vjet e mbyllur - tha si duke qeshur, kur e pyeta se a kishte ndonjë të fejuar a shok - e të betohem nuk kam kohe - mu përgjigj.

Ajo kishte edhe hallin e vet, po të vdiste plaku. Pa shtëpi, pa pune, pa kandidate, por e bën Zoti mire thoshte, duke hedhe shikim drejtë qiellit.

Alma ishte diplomuar në Tirane për shkenca, por ... ja... jeta jone kështu është dikush na ka "nëmur". "Atdheu im nuk më garantoj asgjë - vazhdoi ajo - e u detyrova të marr rrugët e botes ashtu si shume të rinj e të reja të diplomuar. Ja shih pra dinjitetin, që më dha për momentin vendi im. Megjithatë unë i besoj një

dite, një drejtësie, një pranverë që do të vijë edhe në trojet e mia", - përfundoi ajo duke hedhur një "ah" dëshpëruese.

Të nesërmen Alma nuk ishte. Profesori i kishte thane të dilte e të merrte pak fryme për një dy ore. Rreth orës 10 paradite hynë dy burra të veshur shik me kostume e kollare me çanta në duar dhe iu drejtuan plakut.

E ngritën disi në një anë. Nuk i kuptova seç folën, por shkruan diçka e firmosen te tre. Pastaj vunë re se një buzëqeshje i kaloi nëpër fytyrë, që tashmë kishte marrë ngjyrë vjollce.

Në pasdite vone dëgjova Almën, që thërriste me një zë gjysme vaji "profesor", "profesor"!!! Erdhi ekipi mjekësor, infermieret, doktori roje e të tjerë. Vajza e re i kishte ngrit trupin dhe mbështetë mbi krahët e vet. Sytë e profesorit ishin ngrirë në sytë e Almës. Ajo veç qante, ndërsa profesori sikur buzëqeshte. Monitori që mbante parametrat e zemrës filloi të fishkëllej derisa drita jeshile u kthye në të kuqe e vetëm një vizë e drejtë. "Mbaroi" - tha doktori, duke i mbyllur sytë për të mos i hapur kurrë.

Me një të shtymë të derës pak si me forcë hynë dy burrat, që kishin qënë paradite.

Ra heshtja në dhomën e mbushur plot. Ai, më i moshuari nxori një letër nga çanta dhe filloi ta lexojë me zë të larte e gati solemn.

Ishte një testament! Arrita të kap vetëm fjalët: "Pasurinë time të luajtshme e të pa luajtshme, përfshi tokë dhe shtëpi ia la në pronësi Alma M..." dhe në fund emrat e avokatit dhe noterit bashke me firma.

Hodha sytë e pashë Almen. Gjithë ajo vajze ishte mbledhë e bë një grusht e nuk dinte në ishte në një realitet apo jashtë saj. Për herë të parë pas ndërhyrjes në zemër, unë u ngrita nga shtrati dhe i shtriva dorën. Ajo më përqafoi fort me te dyja duart e unë i dukeshja si njeriu më i afërt i saj, i dukeshja një mbështetje ku të fshihte emocionin dhe një keqardhje që ndjente përbrenda.

Ne mbetëm ashtu për një kohë të gjatë me njërin sy te Profesori pa jetë dhe me tjetrin te ajo letër që do të lindte për së dyti një tjetër jete.

Nga **Ndoc Selimi**

GJYSHJA IME LINA

"Zot, mos na len pa gjyshe!"

Anonim.

Na ishte njijherë një gjyshe, quhej Lina. Nuk quhej thjeshtë Lina, por në emnin e vajzërisë quhej, Linë Ujkja. Ishte malësore nga fshati Lekaj, Shalë - Dukagjin.

Ishte vetëm me motrën e saj, kur mbetën jetime, të dyja të mitura, Lina e madhja, vetëm 9 vjeçe. Ishte fillimi i shekullit të 20-të, bash vitet e para.

E siç ndodhte asokohe kur fëmijët mbetnin jetimë, kujdesej dikush nga të afërmit për rritjen e tyre, aq ma shumë që ishin vajza malësore në vende të thella mes malesh në Shalë të Dukagjinit. Më vonë gjyshja do të na tregonte diçka

nga jeta e saj, jo enkas bri zjarrit në votrën e dimnit, por sa herë biseda sillej, duke e ngucë për me tregu nga jeta e saj. Malësorët janë hermetik, aq më shumë vjazat dhe gratë malësore.

Lina ishte e ëma e nanës time, Agetina. Kur u rrita e mora mend', gjithmonë mendoja se, emni Lina, për çdo vajzë, tregonte se ajo ishte malësore dhe Linë nuk mund të quhej kushtjetër, veç një malësore. Kjo pandehmë më ka shoqëruar gjithmonë, fëmijë, i rritur e student, burrë më fëmijë e deri tash vonë.

Kur të mbet' mendja diku, fillon e kërkon fillin.

Të dhënat nga interneti tregojnë se, Lina, janë quajtur në SHBA, 7765 vajza që nga viti 1880 (gjyshja ime ka lindur me 1904) dhe, numëri më i madh i vajzave të quajtura Lina, plot 354, ishte në vitin 2012 në Amerikë, ato sot janë 7 vjeçe. Por Lina si emër, është i përhapur së shumti edhe në Suedi, në Estoni, në Letoni dhe



Lina Ujka

në Lituani, veçanarisht, ato që kanë lindur pas viteve 1980.

Emni Lina i ka rrënjët në persishten e vjetër, po kështu edhe në greqisht, gjermanisht dhe arabisht. Në vitin 2011, ishte emri femëror më popullor në Gjermani, përdorej si shkurtim i emrave, Nikolina, Adelina, Evelina dhe Paulina. Në greqisht, Lina do të thotë "drita e diellit" dhe, gjithashtu, i referohet kurorës së ullirit që përdoret për një hero. Në persisht, do të thotë "dritë", "një rreze drite dielli" ose "vajzë e bukur". Lina, është gjithashtu një formë e shkurtër e çdo emri femër që përfundon në "lina", si Angelina, Evangelina, Karolina, Melina. Në arabisht "Lina" i referohet një peme të vogël palme. Emni Lina gjithashtu ka rrënjë në Francë dhe Kinë. Në kinezisht, "Li" do të thotë "goxha" dhe "Na" do të thotë "elegante".

Mirë moj gjyshe, emni Lina, po mbiemni yt si të rrinte, - "Ujkja"?!.

Edhe këtu u grisha të gjurmoj, ►

SHËNDET PËR TË GJITHË

Data 8 Prill 2019 shënon Ditën Botërore të Shëndetit dhe në kuadër të kësaj dite jemi të ftuar të gjithë si individë të shoqërisë civile të mendojmë, të reflektojmë apo të reagojmë rreth. Në këtë ditë mendja mund të na shkojë në shumë çështje që lidhen me shëndetin.

Mirëpo unë po filloj nga qasja në kujdesin shëndetësor e cila është një e drejtë themelore e njeriut dhe një nga parimet themelore të sistemeve shëndetësore evropiane, së bashku me sigurinë, cilësinë dhe barazinë. Qasja e drejtë dhe e barabartë në trajtimin, kujdesin dhe mbështetjen e duhur për personat është një investim në shoqëri. Megjithatë, të dhënat tregojnë dëshmi të dështimit sistematik të sistemeve shëndetësore për shumë njerëz që aktualisht jetojnë brenda rajonit, veçanërisht të njerëzve në situata të izolimit social ose të varfra. Pabarazitë e vazhdueshme dëmtojnë vlerat themelore të BE-së dhe të drejtat e pacientëve, me një ndikim në kohezionin social dhe rritjen ekonomike.

Si të tjerët, ne e njohim shkallën e barrës shëndetësore të Shqipërisë e cila është një kandidate për tu pranuar si një nga vendet e BE-së. Këto barra shëndetësore janë të përbëra nga barrat ekonomike, si në sistemet shëndetësore ashtu edhe tek individët. Një gjendje e rëndë shëndetësore

që ndodh në një familje në një vend me të ardhura të ulëta, sjell shpenzime katastrofike jashtë xhepit, ndërsa qasja në trajtim është e kufizuar, e kushtueshme dhe shpesh e paefektshme. Njerëzit janë duke mbijetuar në moshë më të vjetra vetëm për të vdekur nga sëmundjet kryesisht të parandalueshme.

Multimorbidityti po rritet në një shkallë të konsiderueshme dhe përbën një barrë të veçantë për të sëmurët dhe familjet e tyre, si dhe sfida specifike për ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe organizimin. Të sëmurët me gjendje të shumëfishta janë edhe më të prekshëm dhe në rrezik të pengesave në qasjen e kujdesit shëndetësor. Ka gjithashtu pabarazi të mëdha brenda dhe mes vendeve, ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Le të mendojmë për shembull, sa persona me sëmundje kronike apo të pashërueshme mund t'ia dalin mbanë me sëmundjen e tyre në këto zona?

Po personat me aftësi të kufizuar që nuk kanë të ardhura të tjera përveç një pensioni social që u jepet nga shteti? Sa dhe si mund t'i kurojnë këto sëmundje? Ky shqetësim u ngrit në seancën e sensibilizimit "Shëndet për të gjithë - pa diskriminim" që u zhvillua me të rinjtë e Shoqatës "Projekti Shpresa". Kush do i mbulojë shërbimet universale shëndetësore për të cilat kanë nevojë? Cilat këshilla duhet të ndjekin që të kujdesin

për shëndetin e tyre?

Shëndetësia duhet të jetë në dispozicion në kohën e duhur për çdo pacient që ka nevojë për të, jo vetëm për ata që mund të paguajnë dhe pavarësisht nga gjinia,



mosha, punësimi dhe statusi i vendbanimit. Për fat të keq, kjo nuk është një realitet për të gjithë. Kjo pabarazi ka nevojë të mos jetë. Por nga ana tjetër, edhe në vendet me të ardhura të larta, përgjithësisht

me norma më të mira mbijetese, barra në rritje e sëmundjeve të ndryshme fizike apo mendore dhe shpenzimet spirale të trajtimit na çojnë në një përfundim të qartë: asnjë vend, megjithatë i pasur, mund të përballojë për të trajtuar rrugën e saj nga problemi të tilla shëndetësore.

Investimi në shëndet është një investim në vlerat themelore të BE-së, në kohezionin social dhe në zhvillimin ekonomik. Reduktimi i Pabarazive ndaj kujdesit të shëndetit janë thelbësore për shëndetin, pasurinë dhe kohezionin e përgjithshëm të shoqërisë.

Ne duhet të kemi një reagim të integruar të parandalimit, zbulimit të hershëm, dhe trajtimit të barabartë. Përgjigja ndaj tyre mundëson më shumë veprimi efektiv. Sigurimi i qëndrueshmërisë së ardhshme të sistemeve shëndetësore është çelësi për realizimin e qëllimeve të zgjuara të Evropës 2020 dhe rritjes gjithëpërfshirëse

Meqë Dita Botërore e Shëndetit ndriçon në qendër të vëmendjes nevojën për mbulimin e Shëndetit Universal - dhe avantazhet që mund të sjellin, atëherë le të jetë një frymëzim dhe një moto që motivon dhe udhëheq vendimmarrësit, politik bërësit e shëndetit dhe palët e interesit për ti kryer këto shërbime ndaj atyre që kanë nevojë për qasje në kujdesin shëndetësor.

Suela Ndoja

ti vihem nga pas "ujkut". "Wolf", në shqip "Ujk", ishte një nga emnat e hershëm gjermanik. Mund të figurojë si element i parë në emrat tematik, ose edhe të motivuar fillimisht nga ujku si një kafshë e shenjtë, por numri i madh i emrave tregon se elementi ishte bërë një sugjerim i pakuptimtë i emrave meshkuj në një kohë të hershme dhe për këtë arsye nuk u konsiderua më një element "pagan".

Mbiemri "Ujk" është një shembull tipik i një mbiemri që rrjedh nga një emër i dhënë, shpesh një origjinë patronimike, don me thanë, mbiemen që rrjedh nga emni i babës. Dhe në malësitë tona, deri vonë, mbiemnat e njerzve ishin patronimik, edhe sot, vajza pas martesës mban në gjendjen civile emnin e babës, dhe në shumë vende të botës edhe emnin e nanës.

Tash, që gërmoja, gjeta atë që desh-ta, të gjeta ty gjyshja ime, emnin dhe mbiemnin tand të kudohasur nëpër botë, në vendet më me traditë dhe qytetërim, në vende me histori mijëra vjeçare, që jetojnë pa komplekse, dhe të lirë. Të lirë ishin edhe njerzit tonë në malet e thella të veriut të Shqipërisë, ato mbartnin dhe ruanin identitetin kombëtar, gjuhën dhe zakonet e tyre, lidhjet e tyre indoeuropiane, paritetin me botën dhe kryenaltësinë e të qenurit ilir e shqiptar.

"Çdo malësor...kur lind, vë kandidaturën për pavdekshmëri", shkruan Indro Montanelli, në librin e tij "Shqipëria një dhe një mijë".

Unë nuk e desha gjyshen time nga emni. Se si bota e ka emnin Lina, në gjuhët e saja, sot po i mësoj. Unë e desha gjyshen se ajo ishte shpirt njeriu, ishte e ambël, e vuajtur, ishte e

pastër, e delirë, e fisme, burneshë e trime.

Nana Linë mbet' e vejë herët, në vitin 1939, kur ajo ishte 35 vjeçe, e re dhe me tre vajza jetime, nana ime më e vogla, vetëm 4 vjeçe, asnjë pasuri mbas shpirtit, një shtëpi në Theth, pak orendi dhe emnin e fafesisit nga i shoqi.

Unë nuk jam rritë me gjyshen, me ninnullat e saj, me tregimin e përrallave nga ajo, jetonte vetëm në shtëpinë e saj, natyrisht në Shkodër.

Por gjyshja ishte e pranishme në jetën tonë me gjithë qenjen e saj, ajo ishte një "shtyllë" edhe në familjen tonë. Ajo ishte rrëfimtaria e një tradite morale dhe burmore, e zakoneve dhe normave të sjelljes së njerzëve me dinjitet, që jetuan dikur në male, ajo ishte një shembull i pathyeshmërisë së njeriut kur ai bie në gjendje të vështirë, kur bie në dëshpërim dhe në pesimizëm. Në të tilla gjendje bie kushdo, edhe burrat, sidomos ato të qytetit. Por gjyshja ime kishte përvoja jetësore dhe ndodhi të tilla në jetën e saj, sa e bante atë një person mbijetues në çdo rrethanë dhe gjendje. E mbetur herët jetime, jeta e mësoj të rritej me halle, me vështirësi. Thoshte vetë, - rrinja në kuvend me burrat e fshatit si e barabartë me to, 14 vjeçe kam mësuar të pi duhan se ashtu duhej, të dukesh e rritur, mbaja paketen e duhanit me vehte dhe, kur fillonte një bisedë në logë të burrave, ja zgjatja paketen bashkëbiseduesit dhe filloja bisedën, - a po e dredhë një cingare, o burrë i malësisë, e kështu fillonte çdo kuvendim për probleme të ndryshme të jetës dhe të vështirësive. Gruaja dhe vajzat në malësitë tona, qoftë në Dukagjin apo në Malësi të Madhe, kanë qenë të mbrojtura,

qoftë nga morali i trashëguar, qoftë edhe nga Kanuni, askush nuk mund ti randontë me fjalë apo, aq më shumë, duke i konsideruar si motrat e veta.

Jeta e mësoj të bante lloj-lloj punësh të vështira. Humbja e burrit e detyroj të merrte vajzat e mitura dhe të "ulej" në Shkodër duke punuar si shërbëtoreshë sanitare në spitalin e ushtrisë gjermane, në shtëpitë e pasanikëve të Shkodrës, ajo ishte e veçantë, mbante në brez edhe një allti turke të vjetër për vetëmbrojtje. Gjithmonë jetoj në Shkodër në shtëpi me qera edhe pse nuk kishte të ardhura të mjaftueshme të përballonte jetesën. Kështu vajzat e veta, pas shkollës 7 vjeçare, i futi në punë dhe në shkollat e natës, si infermjere, pa shkollë nuk i la.

Pas çlirimit të vendit, punoj në Spitalin e qytetit deri në vitin 1960, kur doli në pension. Punoj në punë të shtetit 12 vjet dhe gëzoj pension 33 vite më pas, deri sa qe gjallë, natyrisht, një pension minimal, por të mjaftueshëm me ndihmë edhe familjen tonë me 2500 lekë të asaj kohe, me kalu 15 ditëshat, sa herë kishim nevojë, si të gjitha gjyshet e asaj kohe, që "grumbullonin" lekët si plaga qelbin, me ndihmë vajzat dhe djemtë e tyre kur binin ngushtë.

Nana Linë, edhe në moshë të thyer vinte pasdreke në shtëpinë tonë, gjente momentin kur kthehej im atë nga puna, na sillte ndonjë gjë nga ato që blinte për vehte, ose na "falte" tallonin e mishit (ne ishim tre djem duke u rritur) dhe kishim nevojë të ushqeheshim më mirë, ulej në minderin e kuzhinës e, shpesh aty gjente edhe profesorin e ndritur, - Lluka Karafilin- që e kishim mik shtëpie e kuvendonte

me te, vendçe dhe burrnisht, jo për historinë, por për episode dhe ngjarje të ndryshme nga jeta e saj. Profetori kënaqej. Me homologët e tij diskutonte ndryshe, me Nanën Linë, lirshëm dhe shtruar.

Gjyshja ishte edhe një "amvisë" e mirë në shtëpinë e saj, gatuante mirë mishin me jahni, groshën natyrisht, kosin, por nuk gatuante ambëlsina dhe byrek.

Duhanin e kishte mik të ngushtë. Mund të ketë pi' duhan me të dredhur për afro 80 vjet, por mushkëritë i kishte të pastra, kurrë nuk kollitej, trupin e kishte bilur të pastër, këmbët e drejta e pa asnjë varriçe, krahët e shëndoshë, faqet rozë, qafen pa asnjë rruhdhë, trupin nuk ja kishte pa' kurrë dielli, detin nuk e njihte, ah, malet (!), ato po, i kishte aleat dhe strehë. Çdo pranverë dilte e para në Theth dhe kthehej nga verimi e fundit, nga fundi i Tetorit apo fillimi i Nëntorit, pasi grumbullonte arrat, çajin e malit, pak mazë djathi e pak raki kumbullash. Natyrisht, i shpërndante nga ne.

Ajo e çoj jetën e saj me tre dhëndurë, i parakaloj në jetë, jetoj pas tyre, pas të treve. Secili nga dhëndurët ishin një entitet në vehte dhe me gjyshen kishin marrëdhënie jo si vjehërr dhe dhëndër, por si një zonjë, e ato si të ishin fëmijët e saj, qëndronte mbi ato dhe dinjitare.

Nanën Lina, s'e kemi qyshkur, që nga viti 1993.

Rreshtat i shkruajta për fëmijët e mi, për Toradin e Silvin. Ato kanë shumëçka për të shkruar për gjyshen e tyre, Mariana. E kanë të lehtë, ajo asht Mari.

LEONARD QYTEZA

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

Poezi nga Luigj Temali

Ullini i vogël

Atje në malësi
Në fshatin Drishtë
Pash një ulli
Që ishte i brishtë.

Pema e ullinit
Në anë të rrugës
Në breg të Kirit
Shej i së bukurës.

Njeriu e shihte
Me shumë kujder
Mbi kokë i rrinte
Në çdo shërbesë.

Nga historia
Na vjen një lajm:
“Ndal thotë prona
Mos më ban dam.”

Gjunah për Zotin
Me prek një send
Krejt kot së koti
Vend e pa vend.

Ky asht një lloj
Bagëti e trash
Pa shpirt e soj
Me zemër të vrashd.

Ush gomar

Të pash njome tuj kalu
Ishe e vogël pa u rritë
Ti më le përshtypje mu
Punë të randë paske o çikë!

Moj e vogël porsit bletë
As dhjetë vjet s’i ke mbuish
Nuk e di pse ke mbetë
Mbas gomarit tuj than ush!

More rrugën erdhe për ujë
Te një çezme në qytet
Ishallah kjo gjithëkuj
Do t’i vijë me rubinetë!

I jep shkop me sa fuqi
Ush gomar, a më dëgjon?!
Por veshgjati aty rrin
Dhe me ecë s’pranon!.

Në fund i mbushet mendja
Ndrro dy hapa e ndalon
Në dy anë kalojnë makinat
Vesin e tij nuk e ndryshon!

Klubi i beqarëve

Në tan vendin u hap lajmi
Të lutem vëlla mbaj shënim
U lidh fort besa e beqarit
Për të gjithë pa dallim.

Ky asht Klubi i Beqarëve
Janë bashku me një qëllim
Sa ma larg me u ndej grave
Pa ba ma t’voglin lëshim!

Ka pas thanë një burr i hijshëm
Që në shumë lule pat shëtit:
“Gruaja fut shejtanin në shishe
I mbydh tapën mos me ikë!”

I martuemi ecë me kolpo
Dhe nuk asht krejt i lirë
Mbas atij ajo si rimorkio
Rrugën e ban të vështirë!

Ndodh që në rreshtat e para
Disa të rinj zihen hapsajt
Me një bjonde u feju Kola
Fjalën e tij e morën djajtë!

Me trup në klub mendjen te Jeta
Gjithësecili me një mendim
Para syve u del martesë
Që Përendia i dha bekim.

Kush e ka radhën me shku
Një nga një të dalin jashtë
Klubi të tjerë ka me pranë
Se kjo asht traditë e lashtë!

I urojmë çdo beqari
Nuse të bukur si hyjri
Këtë dhunti e do dhandri
Bashkë me të amblen dashni.

Përpara o burra!

Faliminderit Zotit
Tha një ditë bosit
Të mira pa fund
Solli Babatosi!

Në mjaft vende
U pastru shtëpia
Urdhëroni, zotni “Mere”
Të na rrojë miqësia

Përpara o burra
Ta shpejtojmë hapin
Se atje te rruga
Erdhi firma Gabi...!

Ah, moj kuletë!
A ban me të thanë?
A mundësh me e gjetë
Pse njerëzit i ndanë?!

Dikush në një shtet
I pati në shtat
Kurse sot o Met
Ti po i vesh prap!

!Shyqyr tha Coli
U veshëm me rroba
Se dikur motit
Ne ishim me copa..!

Poezi nga Murat Gecaj

MARTIRIT MËHILL KOLA,
- NGA fshati KAJVALL i Dushmanit...
-Vrarë pa gjyq, në korrik 1946-

N’ Gur të Lekës ka dalë zani:
-Na vranë Mëhill Kolën prej Kajvalli!
Burrë dai, o hajmedet,
prej pabesisë dekën e gjet’!
Kur na erdh’, o komunizmi,
ky Mëhill Kola pushkën ia nisi,
bashkë me djemtë e Duzhmanit,
për traditat e vatanit.
Ky Gjergj Vata u paska pri,
nga Vermoshi e deri në Dri.
Ish Mëhill Kola me shok’t e ti,
ky Ndue Mirashi e Shytan Cani,
Filip Kola e Gjergj Pali...
Të gjithë trima nana i bani,
Zanat e malit u kanë dhanë gj,
ndër beteja u kanë pri...
S’i merr pushka as s’i merr plumbi,
burrninë e tyne e njeh katundi.
Në tanë krahinë zani ka dalë:
Armët e brezi për me na i dhanë,
me i dhanë armët e me i dorëzue!
Ky Mëhill Kola fort asht idhnue,
kur në postë e kanë dërgue:
-S’ kam manxerre as s’ kam allti,
po u ban be në Perëndi.
Komandanti nuk don me ditë,
shpejt po nisë një ekspeditë.
kanë rrethue shtëpinë e Mëhill Kolës,
shpejt ia vunë atij hekurat e dorës!
Hajmedet, nana e tij bërtiti,
gruaja e vajaza sa fort klithi:
-Ku po shkon, o baba jam,
se fort zemra për ty më dhemb?!

Seç u thotë robëve të shkretë:
-Për një fjalë, kanë me na dvetë!
Fjalët s’ vonojnë e n’ oborr kanë dalë,
Mëhillin n’ arrest te e kanë marrë.
Dy ushtarë e kanë shtërngue,
drejt për rrugë e kanë fillue...
Ky Mëhill Kola po mendon:
Ky rregjim fort po na tundon!?
Fjala-fjalës, te kroni kanë mbërri:
A po m’ leni ju, ujë me pi?
-Ec përpara, more tradhëtar,
i ka thanë Teufiku ushtar!
Nuk të lamë na ujë me pi,
as me bukë kurrë me u ngi.
Sa fort Mëhilli asht ngushtue,
vrik prej kronit asht fillue.
Kur ka vu buzën te kroni,
ushtoi mali e ushtoi prroni,
ka qëllue një dorë e zezë,
ket’ Mëhill Kolën e prenë në besë!
Ajo pushkë frymën ia ndali,
medet, bani zana te mali,
te na u vra një trim i rrallë,
me idealin e tij, atdhetar!
Ka shkue zani në Kajvall,
lajmin e zi vesh e kanë marrë.
Ka bërtitë fort nana Kadë,
për at’ djalë që i kanë vramë!
Tri vajza t’ mituna kanë ndie gjamën,
donë të gjallë me e pa babën,
por nuk çohet dot, o hajmedet,
e ka marrë plumbi për gazep,
për gazep e ujë ai tue pi,
ky lloj krimi n’ Malësi nuk asht ndi;
nuk asht ndi as kurrë nuk asht pa,
ndërsa komunistat te e kanë ba?!
Por komunistat nuk janë ngi,
kanë djegë stan e kanë djegë shtëpi!
Robët e shtëpisë i kanë torturue
Dhe në burg ata i kanë ngujue.
Kanë kuvendë zanat në mal:
Këtë Mëhill Kolën na me e marrë,
me e ruejtë në përejetësi,
që mos ta preki ma asnjeri!
Kanga jeme asht një kujtim,
ky Mëhill Kola në zemër na rrin,
kujtimi i tij asht një lapidar,
për te fort malli na ka marrë;
e kujtojnë përherë bijat e tij,
Katrina dhe Lena përherë në zi.
Tash janë ditët në demokraci,
kur ngrihet lart çdo trimni,
njerëz me shpirt e atdhetari...
Po jehojnë Kajvalli e Duzhmani:
Lavdi martirëvë të këtij vatani!

Mundësoi Botimin: **PËLLUMB SHQAU**



REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani,
Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku,
Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj,
Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e
Ndue Ziçi.